

INVESTITOR

"Eco Recycling" Sh.p.k.

Prishtinë



**RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR QENDRËN E
GRUMBULLIMIT, SELEKTIMIT TË MBETURINAVE TË PLASTIKËS, LETRËS,
QELQIT, ALUMINIT SI DHE RECIKLIMIN E PLASTIKËS DHE PRODHIMI I
PRODUKTEVE TË PLASTIKËS**

Korrik - 2026

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR QENDRËN E
GRUMBULLIMIT, SELEKTIMIT TË MBETURINAVE TË PLASTIKËS, LETRËS,
QELQIT, ALUMINIT SI DHE RECIKLIMIN E PLASTIKËS DHE PRODHIMI I
PRODUKTEVE TË PLASTIKËS**

**Ngastra me nr. P-72614051-00116-0, Zona kadastrale
Milloshevë, Komuna e Obiliqit**

Të dhënat e Investitorit	
Aplikuesi	Mentor Ramadani
Iinvestitori	“Eco Recycling” SH.P.K.
Adresa:	Rruga Agim Osaj, Prishtinë
Lokacioni	Milloshevë, Obiliq
Tel:	+383 49 657 600
Email:	ecorecyclingks@gmail.com

Investitori:

“Eco Recycling” SH.P.K.

Emri i Hartuesit të Raportit të VNM-së

Bsc. Hidro. Blerina Bajraktari

Nënshkrimi

Nënshkrimi

Blerinabajraktari1@gmail.com

+383 49 588 634

Korrik - 2026

PËRMBAJTJA:

1.	HYRJE.....	1
2.	PËRSHKRIMI I PROJEKTIT TË PROPOZUAR.....	2
2.1.	Kategoria e Projektit të Propozuar	3
2.2.	Përshkrimi i punëve përgatitore për zbatimin e projektit.....	4
2.3.	Përshkrimi i karakteristikave kryesore të funksionimit të projektit	4
2.4.	Përshkrimi detal i procesit të planifikimit të prodhimit	5
2.5.	Paraqitja e llojit dhe sasisë së burimeve të nevojshme.....	10
2.6.	Vlerësimi i gjenerimit të llojit dhe sasisë së mbeturinave dhe emetimeve gjatë procesit teknologjik	11
2.7.	Prezantimi i teknologjisë së trajtimi, përpunimit, riciklimit dhe asgjësimit të të gjitha llojeve të mbeturinave	12
2.8.	Programi për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar të funksionimit të projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe sipas rastit edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes pas mbarimit të funksionimit të projektit	14
2.9.	Të dhëna për infrastrukturën e nevojshme	15
2.10.	Të dhëna për aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit si ndërtimi i kampeve apo rezidencave.....	15
2.11.	Informacion për lejet dhe licencat e nevojshme për projektin.....	16
2.12.	Informacion për ndërlidhjen e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese	16
3.	PËRSHKRIMI I LOKACIONIT TË PROPOZUAR	18
3.1.	Të dhënat për emrin e lokacionit ku është planifikuar të zbatohet projekti	18
3.2.	Skica dhe planimetria e vendndodhjes së projektit.....	18
3.3.	Distancën me të dhënat për qendrat e banuara në raport me lokacionin ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar me fotografi	21
3.4.	Të dhënat për burimin e furnizimit me ujë	22
3.5.	Paraqitje e karakteristikat pedologjike, gjeomorfologjike, gjeologjike, hidrogeologjike dhe sizmologjike të terrenit	22
3.6.	Paraqitja e karakteristikave klimatike me tregues të përshtatshëm meteorologjik	23
3.7.	Prezantimi i karakteristikat natyrore.....	23
3.8.	Rishikimi i karakteristikat themelore të peizazhit	24
3.9.	Rishikimi i objekteve të mbrojtura të trashëgimisë kulturore dhe historike	25

3.10.	Të dhënat për popullsinë, përqendrimin e popullsisë dhe karakteristikat demografike në lidhje me projektin e planifikuar.....	25
3.11.	Të dhëna për objektet ekzistuese.....	26
3.12.	Në varësi të karakteristikave të zonës, përshkrimi i lokacionit përmban edhe të dhëna për zonat e përcaktuara për kërkime shkencore, vendet arkeologjike, zonat veçanërisht të ndjeshme, zonat me qëllime të veçanta dhe të ngjashme me vlera të veçanta shkencore, arkeologjike dhe mjedisore në hapësirën e projektit	26
3.13.	Të dhënat për burimet ujore në sipërfaqen ku realizohet projekti në afërsi të saj	27
4.	GJENDJAAKTUALE E FAKTORËVE MJEDISOR	28
4.1.	Raport për gjendjen aktuale të faktorëve mjedisor	28
5.	PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TË PROJEKTIT.....	30
5.1.	Përshkrimi i alternativave të realizueshme	30
5.2.	Përshkrimi i alternativave të realizueshme përmban edhe përshkrimin e arsyeve kryesore për zgjedhjen e një alternative të caktuar duke ju referuar.....	31
5.3.	Vendndodhja ose rruga	31
5.4.	Ndikimet në mjedis dhe shëndetin e njeriut.....	31
5.5.	Proceset dhe teknologjia e prodhimit	31
5.6.	Metodat e punës gjatë zbatimit dhe funksionimit të projektit.....	32
5.7.	Plani i lokacionit.....	32
5.8.	Llojin dhe përzgjedhjen e materialeve për realizimin e projektit.....	33
5.9.	Afati kohor për ekzekutimin dhe përfundimin e funksionimit të projektit sipas legjislacionit.....	33
5.10.	Madhësia e lokacionit ose objektit	33
5.11.	Vëllimi i prodhimit	34
5.12.	Kontrolli i ndotjes	34
5.13.	Trajtimin e mbeturinave, përfshirë riciklimin, ripërdorimin, asgjësimin dhe deponimin përfundimtar.....	34
5.14.	Rregullimi i infrastrukturës rrugore të qasjes në projekt dhe rrugë të komunikacioni	35
5.15.	Përgjegjësia dhe procedurat për menaxhimin e mjedisit.....	35
5.16.	Trajnimi	35
5.17.	Monitorimi.....	36
5.18.	Planet për situata emergjente.....	36

5.19.	Demolimi dhe rehabilitimi.....	36
5.20.	Plani për menaxhimin e mjedisit.....	36
5.21.	Përshkrimi i alternativës pa veprim.....	36
6.	PËRSHKRIMI I NDIKIMIT TË PROJEKTIT NË MJEDIS.....	37
6.1.	Përshkrimi i ndikimeve të projektit në mjedis përfshinë.....	37
6.2.	Cilësinë e ajrit.....	37
6.3.	Nivelin dhe përqendrimin e substancave ndotëse në ajër dhe krahasimin me treguesit e përcaktuar me norma dhe standardet sipas legjislacionit në fuqi.....	37
6.4.	Ndikimi i projektit në klimë, lloji dhe vëllimi i emetimeve të gazeve serrë dhe ndjeshmëria e projektit ndaj ndryshimeve klimatike.....	38
6.5.	Mundësinë e ndikimit në ndotjen ndërkufitare të ajrit	38
6.6.	Cilësia e ujit.....	38
6.7.	Ndikimi i ndotësve në cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore	39
6.8.	Mundësinë e ndikimit në ndotjen ndërkufitare të ujërave	39
6.9.	Ndryshimet hidromorfologjike, sasia dhe cilësia me referencë të veçantë për shkarkimet e ujërave të zeza.....	39
6.10.	Toka.....	40
6.11.	Ndikimi fizik, ndryshimi në topografinë lokale, erozioni i tokës, rreshqitjet e tokës, etj.	40
6.12.	Ndikimi i emetimeve të ndotësve në vendndodhjen e projektit dhe në tokën përreth dhe krahasimi me treguesit e përcaktuar me norma dhe standarde sipas legjislacionit përkatës	40
6.13.	Ndikimi në shfrytëzimin e tokës dhe burimeve natyrore	41
6.14.	Sasia dhe cilësia e tokës bujqësore të humbur.....	41
6.15.	Ndikimi në karakteristikat gjeologjike dhe gjeomorfologjike.....	41
6.16.	Popullsia lokale	42
6.17.	Ndryshimet në numrin dhe strukturën e popullsisë dhe ndikimet të lidhura me popullsinë, përqendrimi dhe migrimi	42
6.18.	Ndikimet vizuale të vendbanimeve	42
6.19.	Ndikimet e emetimeve të ndotësve, zhurmës, vibrimeve, nxehhtësisë dhe të gjitha llojet e rrezatimit për shëndetin e njeriut.....	42
6.20.	Ndikimet socio-ekonomike.....	42
6.21.	Ndikimi në strukturën dhe ekonominë lokale, sipas sektorëve prodhues dhe degëve	

kryesore të zonës.....	42
6.22. Numri i vendeve të punës të krijuara gjatë fazave të ndërtimit dhe funksionimit të projektit, si dhe humbjet e mundshme të vendeve të punës në sektorët apo zonat e tjera...	43
6.23. Kontributi i projektit në ekonominë rajonale dhe kombëtare	43
6.24. Ekosistemet dhe gjeologjia	43
6.25. Humbja dhe dëmtimi i specieve bimore dhe shtazore dhe habitateve të tyre	43
6.26. Humbja dhe dëmtimi i veçorive gjeologjike, paleontologjike dhe gjeomorfologjike, biodiversitetit, florës dhe faunës, pasurive natyrore të mbrojtura, specieve të ralla dhe të rrezikuara të bimëve dhe kafshëve dhe habitateve të tyre.....	44
6.27. Qëllimi dhe shfrytëzimi i sipërfaqeve	44
6.28. Sipërfaqet e ndërtuara dhe të pa ndërtuara	44
6.29. Shfrytëzimi i tokës	44
6.30. Infrastrukturë komunale.....	44
6.31. Trafiku.....	45
6.32. Furnizimi me ujë	45
6.33. Energjia	45
6.34. Ujërat e zeza	45
6.35. Gjenerimi i mbeturinave.....	45
6.36. Pasuritë e mbrojtura natyrore, kulturore dhe rrethina e tyre, veçoritë e peizazhit....	46
6.37. Përshkrimi i ndikimeve të projektit në mjedis përmban gjithashtu informacionet që rezultojnë nga	46
6.38. Zbatimi i projektit, duke përfshirë punimet e largimit, sipas rastit	46
6.39. Ndikimet kumulative të projekteve të tjera ekzistuese.....	47
6.40. Të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis.....	47
6.41. Shkarkimi i ujërave të ndotura gjatë fazës së ndërtimit.....	47
6.42. Emetimet e rezatimit elektromagnetik gjatë ndërtimit.....	47
6.43. Emetimet në ajër të gazrave serrë gjatë operimit.....	47
6.44. Ndikimet në ndryshimet klimatike.....	47
7. PËRSHKRIMI I MASAVE PËR TË PARANDALUAR, REDUKTUAR OSE ELIMINUAR NDIKIMIN NË MJEDIS	48
7.1. Masat e parashikuara me legjislacion	48
7.2. Masat që duhen marrë në rast aksidentesh dhe fatkeqësish të mëdha.....	49
7.3. Planet dhe zgjidhjet teknike për mbrojtjen e mjedisit	49
7.4. Masat të tjera që mund të ndikojnë në parandalimin, zvogëlimin ose neutralizimin e	

efekteve të dëmshme në mjedis.....	51
8. PROGRAMI I MONITORIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS.....	53
8.1. Programi i monitorimit të ndikimit në mjedis.....	53
8.2. Prezantimi i gjendjes mjedisore para se projekti të vihet në punë ose fillimi i aktiviteteve në vendet ku ndikimi mjedisor pritet.....	53
8.3. Parametrat në bazë të cilave mund të përcaktohen efektet e dëmshme në mjedis ...	54
8.4. Vendet, mënyra dhe shpeshtësia e matjes së parametrave të përcaktuar	54
8.5. Përmbajtja dhe dinamika e dorëzimit të raporteve për matjet e kryera	55
8.6. Detyrimin për informuar publikun për rezultatet e matjeve të kryera	55
8.7. Programin ndërkufitar të monitorimit të ndikimit në mjedis.....	55
9. PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR	56
9.1. Mbrojtja efektive mjedisore gjatë gjithë fazave të projektit	56
9.2. Pajtueshmëria me pëlqim mjedisor	56
9.3. Inkurajimi i zhvillimit të sistemit të menaxhimit mjedisor në përputhje me standardin ISO 14000.....	57
10. INFORMACIONE SHITESË DHE KARAKTERISTIKAT E PROJEKTIT.....	58
10.1. Informacionet dhe karakteristikat shitesë të projektit për përcaktimin e qëllimit dhe përmbajtjes së raportit të VNM -së,.....	58
11. BURIMET E TË DHËNAVE	59
11.1. Lista e referimit të burimeve e të dhënave të përdorura për përshkrimet dhe vlerësimet e dhëna në raportin e VNM-së.....	59
12. SHTOJCA.....	59
13. PËRMBLEDHJA JO-TEKNIKE E INFORMACIONIT.....	60
13.1. Hyrje.....	60
13.2. Përshkrimi i projektit.....	60
13.3. Ndikimet kryesore mjedisore dhe masat mbrojtëse	61
13.4. Përfitimet socio-ekonomike	62
13.5. Përfundim.....	63

Lista e Figurave

Figura 1. Skema teknologjike e përpunimit të plastikës.....	7
Figura 2. Skema teknologjike e linjës së prodhimit të fletës plastike dhe termoformim	9
Figura 3. Disa nga produktet të cilat prodhohen nga plastika e recikluar.....	10

Figura 4. Lokacioni i kompanisë ne raport me objektet tjera.....	17
Figura 5. Plan Situacioni i objektit.....	19
Figura 6. Shtrirja hapësinore e Lokacionit të projektit që do të ndërtohet në territorin e Komunës së Obiliqit	20
Figura 7. Distanca e kompanisë me qytetin e Obiliqit	20
Figura 8. Distanca kufirit të parcellës me shtëpitë e banimit	21
Figura 9. Distanca e qendrës me objektet tjera	26
Figura 10. Distanca e objektit nga lumi	27

Lista e Tabelave:

Tabela 1. Kodet e mbeturinave për aplikim.....	3
--	---

1. HYRJE

Raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është përgatitur për projektin “Qendra e Grumbullimit dhe Selektimit të Mbeturinave të Plastikës, Letrës, Qelqit dhe Aluminit, si dhe Riciklimin e Plastikës dhe Prodhimin e Produkteve të Plastikës”, të kompanisë “Eco Recycling” SH.P.K. Projekti planifikohet të zhvillohet në Zonën Kadastrale Milloshev, Komuna e Obiliqit, në objekt ekzistues të përshtatur për zhvillimin e këtij aktiviteti.

Aktiviteti kryesor i projektit përfshin grumbullimin dhe selektimin e mbeturinave të plastikës, letrës, qelqit dhe aluminit, si dhe përpunimin dhe riciklimin e plastikës për prodhimin e granulatit dhe produkteve të reja plastike. Për këtë qëllim, projekti parasheh funksionimin e linjës për riciklimin e plastikës dhe linjës për prodhimin e fletëve plastike me termoformim.

Hartimi i këtij raporti bazohet në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe në kërkesat ligjore në fuqi për mbrojtjen e mjedisit në Republikën e Kosovës. Qëllimi i raportit është identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të mundshme në mjedis gjatë funksionimit të qendrës dhe fabrikës, si dhe përcaktimi i masave për parandalimin, zvogëlimin dhe menaxhimin e këtyre ndikimeve.

Projekti ka rëndësi mjedisore, pasi kontribuon në ndarjen, riciklimin dhe ripërdorimin e materialeve të riciklueshme, duke zvogëluar sasinë e mbeturinave që përfundojnë në deponi. Aktiviteti nuk parasheh djegie të mbeturinave dhe nuk përfshin procese të rënda kimike. Ndikimet e mundshme lidhen kryesisht me zhurmën nga makineritë, mbetjet nga selektimi dhe prodhimi, konsumin e energjisë elektrike, qarkullimin e automjeteve dhe nevojën për menaxhim të rregullt të hapësirës së punës.

2. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT TË PROPOZUAR

Projekti i propozuar ka të bëjë me funksionalizimin e qendrës për grumbullimin dhe selektimin e mbeturinave të plastikës, letrës, qelqit dhe aluminit, si dhe me riciklimin e plastikës dhe prodhimin e produkteve të plastikës nga kompania “Eco Recycling” SH.P.K. Aktiviteti do të zhvillohet në objekt ekzistues, në Zonën Kadastrale Milloshev, Komuna e Obiliqit.

Në kuadër të projektit parashihet pranimi i mbeturinave të riciklueshme, kontrollimi fillestar, ndarja sipas llojit të materialit dhe magazinimi i përkohshëm i tyre në hapësira të veçanta. Mbeturinat e letrës, qelqit dhe aluminit do të selektohen, paketoen ose përgatiten për dorëzim te operatorët përkatës të licencuar apo për tregun e riciklimit.

Pjesa kryesore e përpunimit teknologjik lidhet me mbeturinat plastike. Plastika e pranuar do të selektohet manualisht dhe automatikisht, do të pastrohet nga papastërtitë, do të grimcohet dhe më pas do të përpunohet përmes ekstrudimit, filtrimit dhe granulimit. Produkti final i kësaj faze është granulati plastik, i cili mund të përdoret si lëndë e parë për prodhim të mëtejshëm.

Në projekt parashihet edhe linja për prodhimin e fletëve plastike dhe termoformim. Në këtë linjë, granulati ose lënda e parë plastike përpunohet në ekstruder për krijimin e fletëve plastike, të cilat pastaj kalojnë në procesin e termoformimit dhe prerjes për prodhimin e produkteve finale plastike.

Pajisjet kryesore të projektit përfshijnë hapësirat për grumbullim dhe selektim, tavolinën për selektim manual, sistemin automatik të ndarjes, pajisjen për grimcim, ekstruderin me filtër, granulatorin, silot për magazinim të granulatit, ekstruderin për fletë plastike, makinën për termoformim dhe prerje, konvejerin, grumbulluesin e produkteve, panelin elektrik, kompresorin e ajrit dhe pompën e vakumit.

Procesi teknologjik nuk parasheh djegie të mbeturinave dhe nuk përfshin procese të rënda kimike.

Mbeturinat që nuk janë të përshtatshme për riciklim do të ndahen, do të grumbullohen në kontejnerë të veçantë dhe do të dorëzohen te operatorët e licencuar për menaxhimin e mbeturinave. Mbetjet plastike të pastra nga prerja dhe prodhimi mund të rikthehen përsëri në procesin e riciklimit.

Qëllimi i projektit është grumbullimi, selektimi dhe menaxhimi i materialeve të riciklueshme, riciklimi i plastikës dhe prodhimi i produkteve të reja plastike. Projekti kontribuon në zvogëlimin e sasisë së mbeturinave që përfundojnë në deponi, në ripërdorimin e materialeve dhe në zhvillimin e ekonomisë qarkore. Ndikimet e mundshme në mjedis pritet të jenë lokale dhe të menaxhueshme, me zbatimin e masave të parapara në këtë raport.

Tabela 1. Kodet e mbeturinave për aplikim

Kodet e mbet.	Trajtimi I Mbeturinës
02 01 04	Mbeturinat nga plastika copëtohen dhe dërgohen tek kompanitë për riciklim
03 03 08	Mbeturinat nga klasifikimi i letrës dhe kartonit të destinuara për riciklim
07 02 13	Copëtohet dhe shitet tek kompanitë për riciklim
10 03 05	Ndarje fizike, seleksionohet alumini dhe shitet tek kompanitë e përpunimit
15 01 01	Asgjësim i ambalazhes së letrës dhe kartonit, në disa raste kur letra dhe kartoni është i pastër ndahet dhe shitet tek kompanitë e riciklimit
15 01 02	Amballazhet e plastikës, seleksionohen dhe riciklohen në granul, dhe me granul prodhohet produkte të fletëzave të plastikës
16 01 19	Mbeturinat nga plastika copëtohen dhe riciklohet, pastaj prodhohet
16 01 20	Grumbullohet dhe dërgohet tek kompanitë e riciklimit
17 02 02	Grumbullohet dhe dërgohet tek kompanitë e riciklimit
17 02 03	Grumbullohet, seleksionohet dhe copëtohet dhe pastaj riciklohet
17 04 02	Grumbullohen ndahen fizikisht dhe pastaj dërgohen tek qendrat e grumbullimit të metaleve
19 12 01	Grumbullim, seleksionim, paketim dhe pastaj dërgon tek qendrat për riciklim
19 12 04	Plastika grumbullohet, seleksionohet dhe riciklohet ndërsa goma largohet si mbeturinë
19 12 05	Grumbullohet dhe dërgohet tek kompanitë e riciklimit
20 01 01	Grumbullim, paketim dhe dërgohet tek kompanitë e riciklimit
20 01 02	Grumbullohet dhe dërgohet tek kompanitë e riciklimit
20 01 39	Grumbullohet, seleksionohet dhe riciklohet në granul, pastaj prodhohet produkte të plastikës

Në tabelën e mësipërme janë paraqitur Kodet e mbeturinave sipas U.A. Nr. 13 /2013 për Katalogun Shtetëror të Mbeturinave.

2.1. Kategoria e Projektit të Propozuar

Projekti i propozuar i kompanisë “Eco Recycling” SH.P.K. bën pjesë në kategorinë e projekteve për grumbullimin, selektimin dhe trajtimin e mbeturinave të plastikës, letrës, qelqit dhe aluminit, si dhe në kategorinë e projekteve për riciklimin e plastikës dhe prodhimin e produkteve plastike.

Aktiviteti përfshin pranimin dhe selektimin e mbeturinave të plastikës, letrës, qelqit dhe aluminit, si dhe përpunimin e plastikës përmes linjës së riciklimit dhe linjës për prodhimin e fletëve plastike me termoformim.

Bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, projekti i nënshtrohet procedurës së VNM-së, pasi lidhet me menaxhimin dhe përpunimin e mbeturinave, përdorimin e pajisjeve teknologjike dhe prodhimin e produkteve të plastikës.

Projekti do të zhvillohet në objekt ekzistues, në Zonën Kadastrale Milloshev, Komuna e Obiliqit. Ndikimet e mundshme pritet të jenë lokale dhe të menaxhueshme, kryesisht nga

zhurma e makinerive, mbetjet nga selektimi, qarkullimi i automjeteve, konsumi i energjisë elektrike dhe nevoja për ventilim të përshtatshëm.

2.2. Përshkrimi i punëve përgatitore për zbatimin e projektit

Projekti i kompanisë “Eco Recycling” SH.P.K. do të zhvillohet në objekt ekzistues, në Zonën Kadastrale Milloshev, Komuna e Obiliqit. Meqenëse objekti është i ndërtuar, nuk parashihen punime të mëdha ndërtimore, por vetëm punë përgatitore për përshtatjen e hapësirës dhe vendosjen e pajisjeve të nevojshme për grumbullim, selektim, riciklim dhe prodhim.

Punët përgatitore përfshijnë pastrimin dhe organizimin e hapësirës së brendshme, kontrollimin e gjendjes së objektit, rregullimin e bazamenteve për makineritë dhe ndarjen funksionale të zonave të punës. Brenda objektit do të përcaktohen hapësirat për pranimin e mbeturinave të plastikës, letrës, qelqit dhe aluminit, selektimin e tyre, magazinimin e përkohshëm, riciklimin e plastikës, prodhimin e granulit, prodhimin e fletëve plastike, termoformimin dhe magazinimin e produkteve finale.

Në këtë fazë do të bëhet montimi i pajisjeve për selektim dhe magazinim të materialeve të riciklueshme, si dhe montimi i dy linjave kryesore teknologjike: linjës për riciklimin e plastikës dhe linjës për prodhimin e fletëve plastike me termoformim. Po ashtu do të përgatiten instalimet elektrike, ndriçimi, ventilimi, sistemi i ajrit të kompresuar, sistemi i vakumit dhe qasja e brendshme për lëvizjen e punëtorëve dhe materialeve.

Para fillimit të operimit do të bëhet kontrollimi dhe testimi i pajisjeve teknologjike, përfshirë pajisjet për selektim, grimcim, ekstrudim, filtrim, granulim, prodhim të fletëve plastike, termoformim dhe prerje. Testimi do të kryhet për të verifikuar funksionimin e rregullt të pajisjeve dhe sigurinë teknike gjatë punës.

Gjithashtu, do të vendosen kontejnerët për grumbullimin e mbetjeve që nuk janë të përshtatshme për riciklim, si dhe do të caktohen hapësirat për ruajtjen e përkohshme të materialeve të selektuara. Mbeturinat e papërshtatshme do të dorëzohen te operatorët e licencuar për menaxhimin e mbeturinave.

Para fillimit të punës, punëtorët do të njoftohen me mënyrën e funksionimit të qendrës, përdorimin e pajisjeve, ndarjen e mbeturinave sipas llojit dhe masat bazë për siguri në punë dhe mbrojtje nga zjarri. Pas përfundimit të këtyre punëve, projekti do të jetë i gatshëm për fillimin e operimit të rregullt.

2.3. Përshkrimi i karakteristikave kryesore të funksionimit të projektit

Funksionimi i projektit të kompanisë “Eco Recycling” SH.P.K. bazohet në grumbullimin, selektimin e mbeturinave të plastikës, letrës, qelqit dhe aluminit, si dhe riciklimin e plastikës

dhe prodhimin e produkteve të plastikës. Aktiviteti do të zhvillohet brenda objektit ekzistues në Zonën Kadastrale Milloshev, Komuna e Obiliqit.

Në fazën e parë bëhet pranimi i mbeturinave të plastikës, letrës, qelqit dhe aluminit. Pas pranimit, materialet kontrollohen dhe ndahen sipas llojit. Letra, qelqi dhe alumini do të selektohen, grumbullohen dhe magazinohen përkohësisht në hapësira të veçanta, deri në dorëzimin e tyre te operatorët e licencuar ose te subjektet që merren me riciklimin e këtyre materialeve.

Për mbeturinat plastike parashihet përpunim më i avancuar. Plastika fillimisht selektohet manualisht dhe automatikisht, pastaj largohet materiali i papërshtatshëm. Materiali i përshtatshëm kalon në fazën e grimcimit, ekstrudimit, filtrimit dhe granulimit. Produkti final i kësaj linje është granulati plastik, i cili përdoret si lëndë e parë për prodhim të mëtejshëm ose mund të magazinohet për shitje.

Në kuadër të projektit funksionon edhe linja për prodhimin e fletëve plastike dhe termoformim. Në këtë linjë përdoret granulati plastik ose lëndë tjetër plastike, e cila përpunohet në ekstruder për formimin e fletëve plastike. Më pas fletët kalojnë në makinën e termoformimit dhe prerjes, ku krijohen produktet finale plastike sipas formës dhe dimensioneve të kërkuara.

Procesi teknologjik zhvillohet në mënyrë të kontrolluar brenda objektit të mbyllur. Projekti nuk parasheh djegie të mbeturinave dhe nuk përfshin procese të rënda kimike. Për funksionimin e pajisjeve përdoret kryesisht energji elektrike, ndërsa pajisjet ndihmëse përfshijnë ventilimin, kompresorin e ajrit, pompën e vakumit dhe panelet elektrike të kontrollit.

Mbetjet që krijohen gjatë selektimit, riciklimit, prerjes dhe termoformimit do të ndahen dhe grumbullohen në mënyrë të kontrolluar. Mbetjet plastike të pastra mund të rikthehen në procesin e riciklimit, ndërsa mbetjet e papërshtatshme do të dorëzohen te operatorët e licencuar për menaxhimin e mbeturinave.

Karakteristikat kryesore të funksionimit të projektit janë pranimi dhe selektimi i materialeve të riciklueshme, riciklimi i plastikës, prodhimi i granulit, prodhimi i fletëve plastike dhe produkteve të termoformuara, si dhe menaxhimi i rregullt i mbetjeve të krijuara gjatë aktivitetit.

2.4. Përshkrimi detal i procesit të planifikimit të prodhimit

Procesi i prodhimit në kuadër të projektit të kompanisë “Eco Recycling” SH.P.K. është i organizuar në tri pjesë kryesore: grumbullimi dhe selektimi i mbeturinave të plastikës, letrës, qelqit dhe aluminit si dhe riciklimi i plastikës dhe prodhimi i produkteve plastike përmes fletëve plastike dhe termoformimit. Aktiviteti zhvillohet në objekt ekzistues, në Zonën Kadastrale Milloshev, Komuna e Obiliqit.

Fillimisht bëhet pranimi i mbeturinave të plastikës, letrës, qelqit dhe aluminit. Materialet e pranuara kontrollohen vizualisht dhe vendosen në hapësirat e caktuara për selektim. Në këtë fazë bëhet ndarja sipas llojit të materialit, me qëllim që plastika të ndahet nga letra, qelqi, alumini dhe mbeturinat që nuk janë të përshtatshme për riciklim.

Procesi teknologjik i linjës për mbeturinat e letrës, qelqit dhe aluminit

Mbeturinat e letrës dhe kartonit selektohen sipas gjendjes dhe pastërtisë së tyre. Letra e pastër dhe kartoni ndahen nga materiali i lagësht, i ndoturose i kontaminuar. Pas selektimit, letra dhe kartoni presohen, paketojnë dhe magazinohen përkohësisht deri në dorëzimin të operatorët përkatës për riciklim.

Mbeturinat e qelqit selektohen veçmas dhe vendosen në kontejnerë të posaçëm. Gjatë selektimit largohen kapakët, plastika, metali dhe papastërtitë e tjera. Qelqi ruhet në mënyrë të kontrolluar, me qëllim shmangien e përzierjes me materiale të tjera dhe uljen e rrezikut për punëtorët gjatë manipulimit.

Mbeturinat e aluminit, si kanaçet, ambalazhet dhe pjesët e tjera prej alumini, ndahen veçmas nga materialet e tjera. Alumini grumbullohet në hapësirë të caktuar dhe, sipas nevojës, mund të presohet ose pakëtohet për transport më të lehtë. Materiali i selektuar ruhet përkohësisht deri në dorëzimin të subjektet e licencuara për riciklim.

Procesi teknologjik i linjës për riciklimin e plastikës

Linja për riciklimin e plastikës është e organizuar në disa faza teknologjike të njëpasnjëshme, përmes të cilave mbeturinat plastike përpunohen dhe shndërrohen në granulat plastik, i cili mund të përdoret si lëndë e parë për prodhim të mëtejshëm. Procesi zhvillohet sipas këtyre hapave:

1. Selektimi manual

Procesi fillon me pranimin e materialit plastik dhe vendosjen e tij në tavolinën e selektimit manual. Në këtë fazë bëhet ndarja fillestare e materialit plastik nga papastërtitë, materialet e huaja dhe mbetjet që nuk janë të përshtatshme për riciklim. Qëllimi i kësaj faze është sigurimi i një materiali sa më të pastër për përpunim të mëtejshëm.

2. AI Sorting (ndarja automatike)

Pas selektimit manual, materiali kalon në sistemin automatik të ndarjes. Në këtë fazë bëhet ndarja optike e plastikës sipas llojit, ngjyrës dhe cilësisë. Kjo mundëson rritjen e saktësisë në klasifikimin e materialit dhe përmirëson cilësinë e lëndës së parë që vazhdon në proces.

3. Grimcimi (Shredder)

Materiali plastik i përzgjedhur kalon më pas në pajisjen për grimcim, ku copëtohet në pjesë më të vogla, zakonisht me dimensione rreth 10–20 mm. Ky hap është i nevojshëm për ta bërë materialin më të përshtatshëm për fazën e shkrirjes dhe përpunimit në ekstruder.

4. Ekstrudimi dhe filtrimi

Pas grimcimit, materiali futet në ekstruder, ku nxehet dhe shkrihet në kushte të kontrolluara. Gjatë kësaj faze materiali kalon edhe në sistemin e filtrimit, ku largohen papastërtitë e mbetura dhe grimcat e padëshiruara. Ky proces siguron homogjenizimin e masës plastike dhe përmirësimin e cilësisë së produktit final.

5. Granulimi

Materiali plastik i shkrirë dhe i filtruar kalon në fazën e granulimit, ku pritët dhe shndërrohet në granula të vogla plastike. Këto granula paraqesin produktin final të linjës së riciklimit dhe mund të përdoren si lëndë e parë për prodhimin e produkteve të reja plastike.



Figura 1. Skema teknologjike e përpunimit të plastikës

6. Silo granule (magazinimi)

Në fazën përfundimtare, granulat plastike ruhen në silos vertikale ose në thasë të mëdhenj për magazinim të përkohshëm. Nga kjo pikë, materiali mund të përdoret në linjën tjetër të prodhimit ose të përgatitet për shitje dhe shpërndarje.

Në tërësi, linja e riciklimit të plastikës mundëson trajtimin e mbeturinave plastike në mënyrë të kontrolluar dhe kthimin e tyre në lëndë të parë sekondare. Ky proces kontribuon në zvogëlimin e mbeturinave plastike, në ripërdorimin e materialit dhe në zhvillimin e një prodhimi më të qëndrueshëm.

Linja për prodhimin e fletëve plastike dhe termoformim

Linja për prodhimin e fletëve plastike dhe termoformim është e organizuar në disa faza të ndërlidhura teknologjike, të cilat mundësojnë prodhimin e fletëve plastike dhe formimin e produkteve finale. Procesi zhvillohet si më poshtë:

1. Magazina e lëndës së parë

Procesi fillon me pranimin dhe magazinimin e lëndës së parë plastike, si PP, PS, PET, PLA, HIPS ose materiale të tjera të përshtatshme. Lënda e parë ruhet në hapësirë të veçantë dhe përgatitet për furnizim në linjën e prodhimit.

2. Ekstruderi për fletë plastike

Lënda e parë furnizohet në ekstruder, ku nxehet dhe shkrihet në kushte të kontrolluara. Brenda ekstruderit materiali homogjenizohet dhe shtyhet përmes sistemit formues, duke u shndërruar në fletë plastike me trashësi dhe gjerësi të caktuar.

3. Mbledhësi i fletës (Roll Stand)

Pas daljes nga ekstruderi, fleta plastike kalon në mbledhësin e fletës, ku stabilizohet dhe mbledhet në formë roleje. Kjo fazë shërben për sistemimin e materialit dhe përgatitjen e tij për procesin e mëtejshëm të termoformimit.

4. Makina e termoformimit dhe prerjes

Fleta plastike futet në makinën e termoformimit, ku nxehet deri në temperaturën e përshtatshme dhe më pas formohet sipas kallëpit përkatës. Në të njëjtën fazë bëhet edhe prerja e produktit sipas dimensioneve dhe formës së kërkuar.

5. Konveyori dhe prerja e produktit

Pas termoformimit, produktet kalojnë në konveyor, ku transportohen në mënyrë të vazhdueshme. Në këtë pjesë realizohet ndarja e produkteve nga mbetjet anësore ose përfundimi i prerjes së tyre.

6. Grumbullimi i produkteve (Stacker)

Produktet e gatshme grumbullohen automatikisht në sistemin e grumbullimit, ku sistemohen dhe përgatiten për kontroll, paketim dhe magazinim.

7. Paneli elektrik kryesor

I gjithë procesi kontrollohet përmes panelit elektrik kryesor, i cili mundëson komandimin, monitorimin dhe koordinimin e pajisjeve të linjës.

8. Kompresori i ajrit

Kompresori furnizon linjën me ajër të kompresuar, i cili nevojitet për funksionimin e pjesëve pneumatike të pajisjeve dhe për procesin e formimit të produktit.

9. Pompa e vakumit

Pompa e vakumit përdoret gjatë procesit të termoformimit për tërheqjen e fletës plastike mbi kallëp, duke mundësuar formimin e saktë të produktit final.

Në fund të procesit, produktet plastike të formuara kontrollohen për cilësi, pakëtohen dhe vendosen në magazinë për ruajtje ose shpërndarje në treg. Mbetjet plastike të krijuara gjatë prerjes dhe formimit, nëse janë të pastra, mund të rikthehen në procesin e riciklimit dhe të përdoren përsëri si lëndë e parë sekondare.




Figura 2. Skema teknologjike e linjës së prodhimit të fletës plastike dhe termoformim



Figura 3. Disa nga produktet te cilat prodhohen nga plastika e ricikluara

2.5. Paraqitja e llojit dhe sasisë së burimeve të nevojshme

Për funksionimin e projektit të kompanisë “Eco Recycling” SH.P.K. nevojiten burime materiale, energjetike, teknike dhe njerëzore. Këto burime do të përdoren për grumbullimin dhe selektimin e mbeturinave të plastikës, letrës, qelqit dhe aluminit, si dhe për riciklimin e plastikës dhe prodhimin e produkteve plastike.

Burimi kryesor material janë mbeturinat e riciklueshme që pranohen në qendër. Këtu përfshihen mbeturinat e plastikës, letrës, kartonit, qelqit dhe aluminit. Letra, qelqi dhe alumini do të selektohen, magazinohen përkohësisht dhe do të përgatiten për dorëzim te operatorët e licencuar ose subjektet përkatëse për riciklim.

Për linjën e riciklimit të plastikës, burimi kryesor është materiali plastik i përshtatshëm për riciklim. Plastika pas selektimit do të grimcohet, ekstrudohet, filtrohet dhe granulohet. Kapaciteti i planifikuar i kësaj linje është rreth 2 ton/orë, varësisht nga lloji dhe cilësia e materialit plastik të pranuar.

Për linjën e prodhimit të fletëve plastike dhe termoformimit do të përdoret granulat plastik i prodhuar nga linja e riciklimit ose lëndë tjetër plastike e përshtatshme për prodhim. Kjo lëndë

e parë do të përdoret për prodhimin e fletëve plastike dhe formimin e produkteve finale plastike përmes procesit të termoformimit.

Burimi kryesor energjetik është energjia elektrike. Ajo do të përdoret për funksionimin e pajisjeve të selektimit, grimcimit, ekstrudimit, granulimit, prodhimit të fletëve plastike, termoformimit, ndriçimit, ventilimit, kompresorit të ajrit, pompës së vakumit dhe paneleve elektrike të kontrollit.

Uji do të përdoret kryesisht për nevoja sanitare të punëtorëve dhe për pastrim të hapësirave të punës. Projekti nuk parasheh përdorim të madh të ujit në procesin kryesor teknologjik, përveç rasteve kur pajisjet kërkojnë ftohje ose pastrim teknik.

Për funksionimin e linjës së termoformimit nevojitet edhe ajër i kompresuar dhe vakum. Ajri i kompresuar përdoret për pjesët pneumatike të pajisjeve, ndërsa vakumi përdoret gjatë formimit të produkteve plastike në kallëpe.

Për zhvillimin e aktivitetit nevojitet edhe fuqi punëtore për pranimin e materialeve, selektimin, kontrollin e linjave, mirëmbajtjen, paketimin, magazinimin dhe administrimin e procesit. Numri i punëtorëve do të përcaktohet sipas vëllimit të punës dhe ndërrimeve, ndërsa për operim të rregullt pritet të angazhohet staf teknik dhe operativ i trajnuar.

Në përgjithësi, burimet e nevojshme për projektin janë: mbeturinat e plastikës, letrës, qelqit dhe aluminit, granulati plastik ose lënda e parë plastike për prodhim, energjia elektrike, uji, ajri i kompresuar, sistemi i vakumit, pajisjet teknologjike dhe fuqia punëtore.

2.6. Vlerësimi i gjenerimit të llojit dhe sasisë së mbeturinave dhe emetimeve gjatë procesit teknologjik

Gjatë funksionimit të projektit të kompanisë “Eco Recycling” SH.P.K. pritet të krijohen mbeturina dhe emetime të kufizuara, të cilat lidhen me procesin e grumbullimit, selektimit, riciklimit të plastikës dhe prodhimit të produkteve plastike. Aktiviteti zhvillohet brenda objektit ekzistues dhe nuk parasheh djegie të mbeturinave apo procese të rënda kimike.

Mbeturinat kryesore që mund të krijohen gjatë procesit janë mbetjet e papërshtatshme nga selektimi i plastikës, letrës, qelqit dhe aluminit, papastërtitë e ndara nga materiali i pranuar, ambalazhet e dëmtuara, mbeturinat komunale nga punëtorët, si dhe mbetjet plastike nga prerja dhe termoformimi. Mbetjet plastike të pastra do të rikthehen përsëri në procesin e riciklimit, ndërsa mbetjet që nuk janë të përshtatshme do të grumbullohen veçmas dhe do të dorëzohen te operatorët e licencuar.

Mbeturinat e letrës, qelqit dhe aluminit nuk do të përpunohen industrialisht brenda objektit. Ato do të selektohen, do të magazinohen përkohësisht dhe do të përgatiten për transport. Gjatë

këtij procesi mund të krijohen sasi të vogla të materialeve të papastra, të lagështa ose të kontaminuara, të cilat do të ndahen nga materiali i riciklueshëm dhe do të menaxhohen si mbeturina të papërshtatshme.

Në linjën e riciklimit të plastikës mund të krijohen mbetje nga selektimi, pluhur i lehtë plastik gjatë grimcimit, si dhe papastërti të ndara gjatë filtrimit të materialit të shkrirë. Sasia e këtyre mbetjeve varet nga cilësia e plastikës së pranuar. Nëse materiali pranohet i pastër dhe i selektuar mirë, sasia e mbetjeve të papërshtatshme pritet të jetë e vogël.

Në linjën për prodhimin e fletëve plastike dhe termoformim krijohen kryesisht mbetje plastike nga prerja e produkteve dhe pjesët anësore të fletëve plastike. Këto mbetje, nëse janë të pastra, do të rikthehen në procesin e riciklimit dhe do të përdoren përsëri si lëndë e parë. Kjo e zvogëlon sasinë e mbeturinave që duhet të largohen nga objekti.

Emetimet në ajër pritet të jenë të kufizuara. Gjatë grimcimit mund të paraqitet pluhur i lehtë plastik, ndërsa gjatë ekstrudimit, granulimit dhe termoformimit mund të krijohen aroma të lehta ose avuj nga ngrohja e materialit plastik. Këto ndikime do të kontrollohen përmes ventilimit të përshtatshëm, mirëmbajtjes së pajisjeve dhe kontrollit të temperaturës së procesit.

Zhurma do të krijohet nga pajisjet teknologjike, si pajisja për grimcim, ekstruderi, granulatori, makina e termoformimit, kompresori i ajrit, pompa e vakumit dhe pajisjet ndihmëse. Meqenëse procesi zhvillohet brenda objektit të mbyllur, ndikimi i zhurmës pritet të jetë lokal dhe i menaxhueshëm.

Ujërat e ndotura teknologjike nuk pritet të krijohen në sasi të mëdha. Uji do të përdoret kryesisht për nevoja sanitare të punëtorëve dhe për pastrim të hapësirave të punës. Nëse gjatë procesit përdoret ujë për ftohje të pajisjeve, ai duhet të qarkullojë në sistem të kontrolluar ose të menaxhohet sipas kushteve teknike.

Në përgjithësi, mbeturinat dhe emetimet që krijohen gjatë funksionimit të projektit pritet të jenë lokale dhe të menaxhueshme. Menaxhimi do të bëhet përmes ndarjes së mbeturinave në burim, magazinimit të përkohshëm në hapësira të caktuara, rikthimit të mbetjeve plastike të pastra në proces, ventilimit të objektit dhe dorëzimit të mbeturinave të papërshtatshme te operatorët e licencuar.

2.7. Prezantimi i teknologjisë së trajtimit, përpunimit, riciklimit dhe asgjësimit të të gjitha llojeve të mbeturinave

Në kuadër të projektit të kompanisë “Eco Recycling” SH.P.K. do të zbatohet teknologji e organizuar për grumbullimin, selektimin, trajtimin dhe riciklimin e mbeturinave të plastikës,

letrës, qelqit dhe aluminit. Aktiviteti do të zhvillohet brenda objektit ekzistues, në hapësira të ndara sipas llojit të materialit dhe procesit teknologjik.

Mbeturinat e pranuara fillimisht do të kontrollohen dhe selektohen sipas llojit. Plastika do të ndahet nga letra, qelqi, alumini dhe materialet e papërshtatshme. Materialet që nuk plotësojnë kushtet për riciklim do të largohen nga procesi dhe do të vendosen në kontejnerë të veçantë. Teknologjia kryesore e përpunimit lidhet me mbeturinat plastike. Plastika e përshtatshme për riciklim do të kalojë në selektim manual dhe automatik, pastaj në grincim, ekstrudim, filtrim dhe granulim. Përmes këtij procesi, mbeturinat plastike shndërrohen në granulat plastik, i cili përdoret si lëndë e parë për prodhimin e fletëve plastike dhe produkteve finale përmes termoformimit.

Në linjën e prodhimit, granulati plastik ose lënda tjetër plastike përpunohet në ekstruder për formimin e fletëve plastike. Fletët pastaj kalojnë në makinën e termoformimit, ku nxehen, formohen me kallëpe dhe priten sipas dimensioneve të kërkuara. Mbetjet plastike të pastra nga prejja dhe termoformimi do të rikthehen në procesin e riciklimit.

Mbeturinat e letrës dhe kartonit do të selektohen sipas pastërtisë dhe gjendjes së tyre. Letra e pastër dhe kartoni do të presohen, paketojnë dhe magazinohen përkohësisht deri në dorëzimin te operatorët e licencuar ose subjektet përkatëse për riciklim.

Mbeturinat e qelqit do të ndahen veçmas dhe do të vendosen në kontejnerë të posaçëm. Gjatë selektimit do të largohen papastërtitë, kapakët, plastika, metali dhe materialet e tjera të përziera. Qelqi nuk do të shkrihet apo përpunohet në lokacion, por do të dorëzohet për riciklim te subjektet e licencuara.

Mbeturinat e aluminit do të selektohen dhe grumbullohen në hapësirë të veçantë. Sipas nevojës, alumini mund të presohet ose paketohet për transport më të lehtë. Edhe ky material nuk do të përpunohet industrialisht në objekt, por do të dorëzohet te operatorët përkatës për riciklim.

Mbeturinat komunale që krijohen nga punëtorët do të grumbullohen në enë të veçanta dhe do të largohen përmes shërbimit të autorizuar. Mbeturinat e papërshtatshme për riciklim, materialet e kontaminuara dhe papastërtitë e ndara gjatë selektimit do të dorëzohen te operatorët e licencuar për trajtim ose asgjësim të mëtejshëm.

Në lokacion nuk parashihet djegie, shkrirje e qelqit apo aluminit, përpunim kimik i mbeturinave apo asgjësim final. Asgjësimi i mbeturinave që nuk mund të riciklohen do të bëhet vetëm përmes operatorëve të licencuar, në përputhje me kërkesat ligjore për menaxhimin e mbeturinave.

Në përgjithësi, teknologjia e menaxhimit të mbeturinave në këtë projekt bazohet në ndarjen në burim, selektimin sipas llojit, riciklimin e plastikës, përgatitjen e letrës, qelqit dhe aluminit për riciklim, rikthimin e mbetjeve plastike të pastra në proces dhe dorëzimin e mbeturinave të papërshtatshme te operatorët e licencuar.

2.8. Programi për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar të funksionimit të projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe sipas rastit edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes pas mbarimit të funksionimit të projektit

Projekti i kompanisë “Eco Recycling” SH.P.K. do të zhvillohet në objekt ekzistues, në Zonën Kadastrale Milloshev, Komuna e Obiliqit. Meqenëse objekti është i ndërtuar, nuk parashihet ndërtim i ri, por vetëm përshtatje e hapësirës së brendshme, organizim i zonave të punës dhe vendosje e pajisjeve për grumbullim, selektim, riciklim dhe prodhim.

Faza përgatitore përfshin pastrimin dhe rregullimin e hapësirës, kontrollimin e gjendjes së objektit, vendosjen e kontejnerëve për materialet e selektuara, përgatitjen e hapësirave për magazinim, montimin e linjës për riciklimin e plastikës dhe montimin e linjës për prodhimin e fletëve plastike me termoformim.

Kohëzgjatja e punëve përgatitore dhe montimit të pajisjeve pritet të jetë rreth 1 deri në 3 muaj, varësisht nga furnizimi me pajisje, lidhjet teknike dhe testimi i linjave. Pas montimit do të bëhet kontrollimi teknik dhe prova e funksionimit të pajisjeve, para fillimit të operimit të rregullt.

Funksionimi i projektit planifikohet të jetë afatgjatë. Kohëzgjatja e operimit do të varet nga mirëmbajtja e pajisjeve, furnizimi me mbeturina të riciklueshme, kërkesat e tregut për produkte plastike dhe respektimi i kushteve ligjore e mjedisore.

Përfundimi i funksionimit të projektit mund të ndodhë vetëm në rast të ndërprerjes së aktivitetit, ndryshimit të destinimit të objektit ose largimit të linjave teknologjike. Në atë rast, kompania duhet të bëjë çmontimin e pajisjeve, largimin e materialeve të mbetura, pastrimin e hapësirës dhe dorëzimin e mbeturinave te operatorët e licencuar.

Meqenëse projekti zhvillohet në objekt ekzistues dhe nuk parashihet ndërhyrje e madhe në tokë, faza e rehabilitimit do të jetë e kufizuar. Rehabilitimi do të përfshijë pastrimin e objektit, largimin e mbeturinave dhe materialeve të mbetura, kontrollimin e sipërfaqeve të punës dhe rikthimin e hapësirës në gjendje të përshtatshme për përdorim tjetër ose për mbyllje të sigurt të aktivitetit.

2.9. Të dhëna për infrastrukturën e nevojshme

Projekti i kompanisë “Eco Recycling” SH.P.K. do të zhvillohet në objekt ekzistues, në Zonën Kadastrale Milloshev, Komuna e Obiliqit. Lokacioni posedon infrastrukturën e nevojshme bazë për zhvillimin e aktivitetit, përfshirë qasjen rrugore, furnizimin me ujë, sistemin e kanalizimit dhe furnizimin me energji elektrike.

Qasja rrugore deri te fabrika është e siguar dhe mundëson hyrjen e automjeteve për transportin e mbeturinave të riciklueshme, si plastika, letra, qelqi dhe alumini, si dhe daljen e produkteve finale dhe materialeve të selektuara. Kjo qasje është e rëndësishme për funksionimin e rregullt të qendrës dhe për organizimin e transportit pa pengesa.

Objekti ka furnizim me ujë, i cili do të përdoret kryesisht për nevoja sanitare të punëtorëve, pastrim të hapësirave të punës dhe, sipas nevojës, për nevoja teknike të pajisjeve. Ujërat sanitare do të shkarkohen në sistemin ekzistues të kanalizimit, ndërsa nuk parashihet krijim i ujërave të ndotura industriale në sasi të mëdha.

Furnizimi me energji elektrike është i siguar dhe do të përdoret për funksionimin e pajisjeve të selektimit, riciklimit të plastikës, prodhimit të fletëve plastike, termoformimit, ndriçimit, ventilimit, kompresorit të ajrit, pompës së vakumit dhe paneleve elektrike të kontrollit.

Brenda objektit do të organizohen hapësirat për pranimin e mbeturinave të riciklueshme, selektimin sipas llojit të materialit, magazinimin e përkohshëm të letrës, qelqit dhe aluminit, riciklimin e plastikës, prodhimin e granulatit, prodhimin e produkteve plastike dhe magazinimin e produktit final.

Për funksionim të sigurt të projektit nevojitet edhe infrastruktura ndihmëse, si ndriçimi i mjaftueshëm, ventilimi i objektit, hapësirat për lëvizjen e punëtorëve, kontejnerët për mbeturinat e papërshtatshme për riciklim, pajisjet për mbrojtje nga zjarri dhe sinjalizimi bazë i sigurisë. Me këtë infrastrukturë, projekti mund të zhvillohet në mënyrë të organizuar dhe të kontrolluar.

2.10. Të dhëna për aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit si ndërtimi i kampeve apo rezidencave

Në kuadër të objektit të planifikuar do të parashihen vetëm hapësirat e nevojshme funksionale, si pjesa administrative, nyjet sanitare, hapësirat për personelin dhe zonat operative për zhvillimin e aktivitetit, dmth nuk parashihet akomodim brenda lokacionit.

2.11. Informacion për lejet dhe licencat e nevojshme për projektin

Për realizimin dhe funksionimin e projektit “Fabrika e Riciklimit dhe Prodhimit të Produkteve të Plastikës”, kompania “Eco Recycling” SH.P.K. duhet të pajiset me lejet, pëlqimet dhe licencat përkatëse, sipas kërkesave ligjore në fuqi..

Lejet dhe autorizimet kryesore që kërkohen për zbatimin e projektit përfshijnë:

1. **Pëlqimi komunal**, i lëshuar nga komuna ku realizohet aktiviteti, për ushtrimin e veprimtarisë në lokacionin përkatës.
2. **Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (VNM)**, i miratuar nga Ministria e Mjedisit, dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-181.
3. **Leja Mjedisore**, e lëshuar nga MMPHI

Të gjitha lejet dhe licencat përkatëse do të sigurohen dhe mirëmbahen gjatë gjithë periudhës së funksionimit të projektit. Aktiviteti i kompanisë do të zhvillohet në përputhje të plotë me kushtet e lejeve të lëshuara, duke garantuar funksionim të rregullt, të ligjshëm dhe në përputhje me kërkesat mjedisore dhe rregullatorë në fuqi.

2.12. Informacion për ndërlidhjen e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese

Projekti i kompanisë “Eco Recycling” SH.P.K. do të zhvillohet në objekt ekzistues, në Zonën Kadastrale Milloshev, Komuna e Obiliqit. Aktiviteti kryesor lidhet me grumbullimin dhe selektimin e mbeturinave të plastikës, letrës, qelqit dhe aluminit, si dhe me riciklimin e plastikës dhe prodhimin e produkteve plastike.

Projekti mund të ketë ndërlidhje funksionale me operatorë të tjerë që merren me grumbullimin, transportin ose furnizimin me mbeturina të riciklueshme. Këta operatorë mund të shërbejnë si burim për furnizimin e qendrës me plastikë, letër, qelq dhe alumin.

Po ashtu, projekti lidhet me operatorët e licencuar për menaxhimin e mbeturinave, të cilëve do t’u dorëzohen mbetjet që nuk janë të përshtatshme për riciklim brenda objektit. Letra, qelqi dhe alumini i selektuar mund të dorëzohen te subjektet përkatëse që merren me riciklimin ose përpunimin e këtyre materialeve.

Ndërlidhje tjetër e mundshme është me kompani prodhuese ose tregtare që përdorin granulat plastik, fletë plastike ose produkte të termoformuara. Produktet e prodhuara në fabrikë mund të shfrytëzohen si lëndë e parë ose si produkte finale për tregun vendor dhe më gjerë.

Projekti nuk parasheh ndërtimin e infrastrukturës së re të veçantë që do të ndikonte drejtpërdrejt në projekte të tjera ekzistuese. Lokacioni ka qasje rrugore, furnizim me ujë, kanalizim dhe energji elektrike, prandaj aktiviteti do të mbështetet në infrastrukturën ekzistuese.



3. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT TË PROPOZUAR

3.1. Të dhënat për emrin e lokacionit ku është planifikuar të zbatohet projekti

Projekti i kompanisë “Eco Recycling” SH.P.K. është planifikuar të zbatohet në Zonën Kadastrale Milloshev, Komuna e Obiliqit, në ngastrën kadastrale me numër P-72614051-00116-0.

Aktiviteti do të zhvillohet në objekt ekzistues, i cili do të shfrytëzohet për qendrën e grumbullimit dhe selektimit të mbeturinave të plastikës, letrës, qelqit dhe aluminit, si dhe për riciklimin e plastikës dhe prodhimin e produkteve të plastikës.

Lokacioni ndodhet në territorin administrativ të Komunës së Obiliqit dhe ka qasje të përshtatshme rrugore për automjetet që do të përdoren për transportin e materialeve të riciklueshme, produkteve finale dhe mbetjeve që do të dorëzohen te operatorët e licencuar.

Në këtë lokacion ekziston infrastruktura bazë e nevojshme për zhvillimin e aktivitetit, përfshirë furnizimin me energji elektrike, ujë dhe kanalizim. Për këtë arsye, projekti nuk kërkon ndërtim të infrastrukturës së re jashtë objektit ekzistues, por vetëm organizim dhe përshtatje të hapësirës për nevojat e aktivitetit.

3.2. Skica dhe planimetria e vendndodhjes së projektit

Vendndodhja e projektit për ndërtimin dhe funksionimin e Qendrës së Grumbullimit, Përpunimit dhe Riciklimit të Mbeturinave të Letrës, Plastikës, Qelqit, Mbeturinave Metalike dhe Mbeturinave të tjera sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave, nga kompania “Eco Recycling” SH.P.K., është paraqitur përmes skicës dhe planimetrisë përkatëse, të cilat ilustrojnë shtrirjen hapësinore të projektit në nivel lokal dhe rajonal. Këto skica shërbejnë për të paraqitur në mënyrë vizuale pozicionin e projektit në raport me territorin e Republikës së Kosovës, Komunën e Obiliqit dhe zonën kadastrale Milloshevë. Në planimetrinë e përgjithshme paraqitet pozicioni i projektit brenda territorit të Republikës së Kosovës, me theks të veçantë në rajonin ku shtrihet Komuna e Obiliqit, duke mundësuar identifikimin e qartë të lokacionit në kontekst më të gjerë gjeografik. Planimetria në nivel lokal paraqet në mënyrë më të detajuar shtrirjen e parcelës kadastrale ku planifikohet të realizohet projekti, përkatësisht parcelën P-72614051-00116-0., në Zonën Kadastrale Milloshevë, Komuna e Obiliqit. Në këtë planimetri paraqitet lokacioni i paraparë për ndërtimin e qendrës, si dhe organizimi i ardhshëm hapësinor i aktivitetit. Brenda parcelës do të planifikohen hapësirat për pranimin e mbeturinave, grumbullimin, ruajtjen e përkohshme, trajtimin, përpunimin dhe riciklimin e mbeturinave të letrës, plastikës, qelqit, mbeturinave metalike dhe mbeturinave të tjera sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave. Po ashtu, në kuadër të lokacionit do të parashihen hapësirat për

qarkullimin e brendshëm të automjeteve, ngarkim dhe shkarkim, magazinim të materialeve të përpunuara, pjesa administrative, si dhe infrastruktura përcjellëse e nevojshme për funksionimin e rregullt të projektit. Në vijim paraqitet shtrirja hapësinore e projektit në lokacionin e planifikuar për ndërtim dhe funksionim, e cila ofron një pasqyrë të qartë të vendndodhjes së projektit dhe ndërveprimit të tij me mjedisin përreth.




Figura 5. Plan Situacioni i objektit

Rruga për qasje në lokacionin e projektit është e paraqitur në planin e situacionit. Sipas vizatimit, qasja kryesore realizohet përmes rrugës lokale e cila kalon në pjesën lindore dhe veriore të lokacionit, e shënuar me parcelën rrugore 119-0.

Nga kjo rrugë lokale sigurohet hyrja direkt në hapësirën e objektit ekzistues dhe në oborrin punues të projektit. Rruga mundëson qarkullimin e automjeteve për transportin e mbeturinave të riciklueshme, si plastika, letra, qelqi dhe alumini, si dhe transportin e produkteve finale dhe materialeve të selektuara.

Në bazë të planit të situacionit, lokacioni ka qasje të përshtatshme rrugore dhe nuk paraqitet nevojë për ndërtimin e rrugëve të reja. Rruga ekzistuese lidhet me parcelat e projektit dhe

mundëson hyrje e dalje të rregullt të automjeteve, duke mbështetur funksionimin normal të qendrës për grumbullim, selektim, riciklim dhe prodhim të produkteve plastike.

Shtirja hapësinore e lokacionit të projektit është paraqitur në vizatimin në vijim.




Figura 6. Shtrirja hapësinore e Lokacionit të projektit që do të ndërtohet në territorin e Komunës së Obiliqit

Në skicat përkatëse është paraqitur gjithashtu lidhja rrugore e lokacionit të projektit me qytetin e Obiliqit dhe zonat përreth, përmes rrjetit ekzistues rrugor. Kjo lidhje siguron qasje funksionale për automjetet transportuese, makineritë dhe aktivitetet e përditshme të operimit të




Figura 7. Distanca e kompanisë me qytetin e Obiliqit

3.3. Distancën me të dhënat për qendrat e banuara në raport me lokacionin ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar me fotografi

Bazuar në ortofoton dhe planin e situacionit, në afërsi të lokacionit gjenden objekte banimi të shpërndara, kryesisht në anën lindore dhe juglindore të parcelave të projektit, përgjatë rrugës lokale. Distanca e objektit të kompanisë me shtëpitë e banimit është 112 metra, me objekt biznesi është 94 metra dhe me objektin e pa banuar është 69 metra, ndërsa nga lumi llap kemi 61 metra, shih ortofoton.




Figura 8. Distanca e objektit të kompanisë me objektet tjera përreth

Kjo distancë duhet të merret parasysh gjatë vlerësimit të ndikimeve të mundshme, sidomos në raport me zhurmën nga makineritë, qarkullimin e automjeteve, ngarkim shkarkimin e materialeve dhe menaxhimin e mbeturinave brenda lokacionit. Megjithatë, aktiviteti do të zhvillohet kryesisht brenda objektit të mbyllur dhe nuk parasheh djegie të mbeturinave apo procese të rënda kimike.

Në raport me vendbanimin Millosheve, lokacioni ndodhet në një zonë me karakter të përzier, ku përreth ka sipërfaqe bujqësore, rrugë lokale, objekte afariste/depo dhe objekte banimi. Qasja në projekt realizohet përmes rrugës lokale ekzistuese, e cila mundëson hyrjen dhe daljen e automjeteve pa pasur nevojë për ndërtimin e rrugëve të reja.

Për shkak të afërsisë me objektet e banimit, gjatë operimit duhet të zbatohen masa mbrojtëse, si zhvillimi i aktivitetit brenda objektit, mirëmbajtja e rregullt e pajisjeve për uljen e zhurmës, organizimi i transportit në orare të përshtatshme, mbajtja e hapësirës së pastër dhe grumbullimi i mbeturinave në kontejnerë të mbyllur ose të kontrolluar.

Shtrirja e lokacionit në raport me objektet e banimit dhe rrugën lokale është paraqitur në fotografitë dhe planin e situacionit në vijim.

3.4. Të dhënat për burimin e furnizimit me ujë.

Furnizimi me ujë për projektin e kompanisë “Eco Recycling” SH.P.K. në Zonën Kadastrale Milloshev, Komuna e Obiliqit, do të sigurohet nga rrjeti ekzistues i ujësjellësit. Lokacioni ku planifikohet të zhvillohet aktiviteti ka qasje në furnizim me ujë, prandaj nuk parashihet hapja e puseve të reja apo shfrytëzimi i burimeve natyrore ujore për nevojat e projektit.

Uji do të përdoret kryesisht për nevoja sanitare të punëtorëve, për pastrimin e hapësirave të punës dhe, sipas nevojës, për mirëmbajtjen teknike të pajisjeve. Procesi kryesor i grumbullimit dhe selektimit të mbeturinave të letrës, qelqit dhe aluminit nuk kërkon përdorim të ujit në sasi të mëdha.

3.5. Paraqitje e karakteristikat pedologjike, geomorfologjike, gjeologjike, hidrogeologjike dhe sizmologjike të terrenit

Nga aspekti geomorfologjik, territori i Komunës së Obiliqit paraqitet kryesisht si zonë fushore dhe kodrinore e ulët. Relievi është përgjithësisht i rrafshët, me pjerrësi të vogla, çka e bën të përshtatshëm për zhvillimin e aktiviteteve industriale dhe infrastrukturore. Në materialet e paraqitura nuk evidentohen forma geomorfologjike të paqëndrueshme apo procese aktive erozive që do të paraqisnin kufizime për zhvillimin e projektit. Sipas të dhënave gjeologjike të paraqitura në PZHK, përbërja gjeologjike e territorit të Komunës së Obiliqit dominohet nga formacionet sedimentare. Nga tabela përkatëse rezulton se rreth 43.98% e territorit përbëhet nga balta, rëra, zhavorri dhe marlina, pjesërisht me linjit. Përbërja lymore zë rreth 21.79%, ndërsa proluviumi përbën rreth 12.04% të sipërfaqes. Në përqindje më të vogël paraqiten edhe aluvionet, sedimentet e liqeneve dhe lumenjve, mermeri, shkëmbinjtë gëlqerorë, kuarcitet dhe formacione të tjera magmatike e metamorfike. Kjo përbërje gjeologjike është tipike për zonat fushore të Kosovës dhe konsiderohet e përshtatshme për veprimtari industriale. Bazuar në përshkrimin hidrografik të paraqitur në PZHK, territori i Komunës së Obiliqit përshkohet nga tre lumenj natyrorë: Sitnica, Drenica dhe Llapi, si dhe nga Kanali Ibër–Lepenc. Lumi Sitnica përbën rrjedhën kryesore ujore dhe përshkon territorin e komunës nga jugu në veri, duke mbledhur rreth 80% të ujërave në drejtim të veriperëndimit. Sitnica karakterizohet nga prurje të ulëta gjatë stinës së verës dhe prurje shumë më të larta gjatë dimrit dhe pranverës, veçanërisht

gjatë shkrires së borës, kur prurjet mund të arrijnë deri në 37.5 m³/s. Në raste të prurjeve të mëdha, lumi mund të dalë nga shtrati dhe të përmytë tokat përreth.

3.6. Paraqitja e karakteristikave klimatike me tregues të përshtatshëm meteorologjik

Bazuar në të dhënat e paraqitura në Planin Zhvillimor Komunal të Komunës së Obiliqit 2022-2030, territori i komunës, përfshirë edhe zonën ku ndodhet lokacioni i projektit, i nënshtrohet ndikimeve klimatike të pellgut të Sitnicës dhe Ibërit. Zona karakterizohet nga një mikroklimë me specifika të veçanta, e ndikuar nga zhvillimi industrial dhe proceset kimiko-teknologjike të aktiviteteve energjetike në rajon. Proceset e emisioneve industriale kanë ndikuar në përhapjen e aerosoleve dhe elementeve të tjera klimatologjike, duke reflektuar veçanërisht në nivelet e lagështisë relative. Në këtë zonë, lagështia relative paraqitet e lartë dhe varion në intervalin prej 47% deri në 95%, ndërkohë që kufijtë normalë zakonisht janë 45%–56%. Temperatura e ajrit paraqitet e ndryshueshme gjatë vitit. Vlera mesatare vjetore e temperaturës është rreth 10.2°C. Muaji më i ftohtë është janari, me temperaturë mesatare rreth –1.5 °C, ndërsa muaji më i nxehtë është gushti, me temperaturë mesatare rreth 20.5 °C. Amplituda vjetore e temperaturës së ajrit arrin rreth 21.9 °C, duke reflektuar një regjim klimatik kontinental. Regjimi klimatik i zonës klasifikohet si klimë mesatare kontinentale, me ndikime të klimës malore, ku vjeshta është mesatarisht më e ngrohtë se pranvera për rreth 1.5 °C. Sa i përket reshjeve atmosferike, zona ndikohet nga aktivitetet ciklonike me prejardhje të ndryshme. Masat ajrore të lagështa dhe të ftohta nga Atlantiku ndikojnë kryesisht gjatë periudhës së vjeshtës dhe dimrit, ndërsa gjatë verës dhe pranverës ndikojnë masat ajrore më të thata nga jugu, hapësira mesdhetare dhe masat e ftohta nga veriu dhe verilindja. Sasia vjetore e reshjeve varion në intervalin prej 670 mm deri në 810 mm. Në aspektin e erërave, drejtimet dominuese janë:

- Veri–Verilindje me rreth 20.3%;
- Veri me rreth 19.4%;
- Jug me rreth 5%;
- Perëndim me rreth 4%.

Era nga drejtimi verilindor është më e shpeshtë gjatë pranverës dhe më e rrallë gjatë dimrit. Qetësia më e madhe e erës vërehet në muajin gusht, ndërsa qetësia më e vogël në muajin prill. Shpejtësia mesatare më e lartë e erës regjistrohet zakonisht në muajin mars, me vlerë rreth 3.2 m/s, ndërsa shpejtësia më e ulët regjistrohet në muajin shtator, me rreth 1.8 m/s.

3.7. Prezantimi i karakteristikat natyrore

Zona ku ndodhet lokacioni i Qendrës së Grumbullimit karakterizohet nga elemente natyrore tipike për territorin e Komunës së Obiliqit dhe Rrafshin e Kosovës. Mjedisi natyror i zonës

është i ndikuar në masë të konsiderueshme nga zhvillimi industrial, infrastruktura energjetike dhe aktivitetet antropogjene të zhvilluara ndër vite. Vegetacioni natyror përreth lokacionit përbëhet kryesisht nga bimësi barishtore dhe shkurre, me prezencë të kufizuar të drurëve përgjatë rrjedhave ujore. Nuk evidentohet prani e pyjeve të dendura, habitateve të mbrojtura apo ekosistemeve natyrore me vlera të veçanta ekologjike në zonën e drejtpërdrejtë të projektit. Fauna e zonës përbëhet kryesisht nga specie të zakonshme të ambientit fushor dhe bujqësor, të cilat janë të përshtatura ndaj pranisë së aktiviteteve industriale dhe qarkullimit të mjeteve. Nuk janë identifikuar specie të rralla, të mbrojtura apo të rrezikuara që do të ndikonin në realizimin e projektit. Territori përreth lokacionit përfshin toka bujqësore, zona industriale ekzistuese dhe infrastrukturë rrugore, ndërsa elementet natyrore janë të fragmentuara për shkak të shfrytëzimit të vazhdueshëm të hapësirës. Afërsia e lumit Sitnica përbën elementin kryesor natyror hidrografik në zonë, megjithatë projekti nuk ka ndërhyrje direkte në mjedisin natyror të tij. Në përgjithësi, karakteristikat natyrore të zonës konsiderohen të zakonshme për këtë pjesë të Kosovës dhe nuk paraqesin ndjeshmëri të veçantë ekologjike. Për këtë arsye, funksionimi I projektit nuk pritet të shkaktojë ndikime të konsiderueshme negative në aspektin e elementeve natyrore, për aq kohë sa zbatohen masat mjedisore të parashikuara.

3.8. Rishikimi i karakteristikat themelore të peizazhit

Peizazhi i zonës ku ndodhet lokacioni i Qendrës së Grumbullimit të Mbeturinave karakterizohet nga një kombinim i elementeve natyrore dhe atyre të krijuara nga njeriu. Zona bën pjesë në territorin fushor të Komunës së Obiliqit, ku peizazhi është formësuar kryesisht nga zhvillimi industrial, aktivitetet energjetike. Nga aspekti vizual, peizazhi dominohet nga objekte dhe struktura industriale ekzistuese, infrastrukturë rrugore, zona të shfrytëzuara për veprimtari ekonomike, si dhe sipërfaqe të hapura me përdorim bujqësor. Elementet natyrore, si bimësia barishtore dhe shkurre, janë të shpërndara në mënyrë të fragmentuar dhe kanë rol sekondar në formësimin e peizazhit. Afërsia e lumit Sitnica paraqet elementin kryesor natyror në peizazh, duke krijuar një korridor linear përgjatë rrjedhës së tij, megjithatë ndikimi vizual i këtij elementi është i kufizuar për shkak të ndërhyrjeve të shumta antropogjene në zonë. Nuk identifikohen pamje panoramike me vlera të veçanta estetike apo peizazhe të mbrojtura në afërsi të drejtpërdrejtë të projektit. Duke qenë se projekti zhvillohet në një lokacion ekzistues, funksionimi I Qendrës së Grumbullimit nuk pritet të sjellë ndryshime të ndjeshme në karakterin e peizazhit. Aktivitetet e propozuara përshtaten me strukturën vizuale ekzistuese të zonës dhe nuk krijojnë kontraste të reja të theksuara në peizazh. Në përgjithësi, peizazhi i zonës

konsiderohet me vlera të zakonshme estetike dhe me ndjeshmëri të ulët ndaj ndryshimeve, prandaj ndikimi i projektit në aspektin e peizazhit vlerësohet si i kufizuar dhe i pranueshëm.

3.9. Rishikimi i objekteve të mbrojtura të trashëgimisë kulturore dhe historike

Në afërsi të drejtpërdrejtë të lokacionit nuk ka monumente kulturore, zona të mbrojtura kulturore apo objekte me vlera historike të shpallura sipas legjislacionit në fuqi. Për këtë arsye, ndërtimi dhe funksionimi i projektit nuk pritet të ketë ndikim në trashëgiminë kulturore dhe historike të zonës.

3.10. Të dhënat për popullsinë, përqendrimin e popullsisë dhe karakteristikat demografike në lidhje me projektin e planifikuar

Sipas Bazuar në të dhënat zyrtare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, të paraqitura në Planin Zhvillimor Komunal të Komunës së Obiliqit, në territorin e komunës jetojnë gjithsej 21,549 banorë të shpërndarë në 20 vendbanime. Struktura moshore e popullsisë tregon se pjesa më e madhe e banorëve i përket grup-moshës aktive 20–64 vjeç, me 55.19% të popullsisë, ndërsa grup-moshat 0–4 vjeç përbëjnë 9.69%, 5–14 vjeç 20.10%, 15–19 vjeç 9.27% dhe personat mbi 65 vjeç 5.75%. Kjo strukturë tregon një popullsi relativisht të re dhe aktive nga aspekti ekonomik.

Sa i përket përbërjes etnike, 92.13% e popullsisë i përket etnisë shqiptare, ndërsa pjesa tjetër përbëhet kryesisht nga komunitetet rome, ashkali dhe serbe, si dhe grupe të tjera etnike në përqindje shumë më të vogla. Për nga përkatësia fetare, dominon besimi islam me 97.68% të popullsisë, ndërsa besimi ortodoks, katolik dhe përkatësitë tjera përfaqësohen në përqindje të vogla.

Në Komunën e Obiliqit janë regjistruar gjithsej 3,852 ekonomi familjare, prej të cilave 33.02% ndodhen në zonë urbane dhe 66.98% në zonë rurale. Numri më i madh i ekonomive familjare përbëhet nga familje me pesë anëtarë, të ndjekura nga familjet me gjashtë anëtarë. Struktura gjinore e popullsisë është relativisht e balancuar, me një dallim minimal ndërmjet meshkujve dhe femrave, ku meshkujt përbëjnë rreth 2.03% më shumë se femrat.

Territori i Komunës së Obiliqit shtrihet në një sipërfaqe prej rreth 105 km², me një dendësi mesatare të popullsisë prej rreth 205 banorë për km², ndërsa dendësia ndryshon nga një vendbanim në tjetrin, me vlera më të larta në zonat urbane dhe më të ulëta në zonat rurale.

Duke marrë parasysh karakterin industrial të zonës ku zhvillohet projekti dhe largësinë nga qendrat e banuara, realizimi dhe funksionimi i projektit nuk pritet të ketë ndikime të drejtpërdrejta në strukturën demografike, shpërndarjen e popullsisë apo karakteristikat sociale të komunës.

3.11. Të dhëna për objektet ekzistuese

Bazuar në ortofoton dhe planin e situacionit, në afërsi të lokacionit gjenden objekte banimi të shpërndara, kryesisht në anën lindore dhe juglindore të parcelave të projektit, përgjatë rrugës lokale. Distanca e objektit të kompanisë me shtëpitë e banimit është 112 metra, me objekt biznesi është 94 metra dhe me objektin e pa banuar është 69 metra, ndërsa nga lumi llap kemi 61 metra, prandaj gjatë operimit duhet të zbatohen masa për kontrollin e zhurmës, qarkullimit të automjeteve dhe menaxhimit të mbeturinave.




Figura 9. Distanca e qendrës me objektet tjera

Duke qenë se aktiviteti do të zhvillohet brenda objektit ekzistues dhe nuk parasheh djegie apo procese të rënda kimike, ndikimi ndaj objekteve përreth pritet të jetë lokal dhe i menaxhueshëm, me kusht që të respektohen masat teknike dhe mjedisore të përcaktuara në këtë raport.

3.12. Në varësi të karakteristikave të zonës, përshkrimi i lokacionit përmban edhe të dhëna për zonat e përcaktuara për kërkime shkencore, vendet arkeologjike, zonat veçanërisht të ndjeshme, zonat me qëllime të veçanta dhe të ngjashme me vlera të veçanta shkencore, arkeologjike dhe mjedisore në hapësirën e projektit

Në hapësirën ku planifikohet ndërtimi dhe funksionimi i Qendrës së Grumbullimit, nuk janë evidentuar zona të përcaktuara për kërkime shkencore, vende arkeologjike, zona veçanërisht të ndjeshme, zona me qëllime të veçanta apo hapësira me vlera të veçanta shkencore, arkeologjike dhe mjedisore. Për këtë arsye, projekti nuk pritet të ketë ndikim në zona të tilla dhe nuk kërkohen masa të veçanta mbrojtëse për këtë aspekt.

3.13. Të dhënat për burimet ujore në sipërfaqen ku realizohet projekti në afërsi të saj

Në afërsi të lokacionit ku planifikohet të zhvillohet projekti i kompanisë “Eco Recycling” SH.P.K., në Zonën Kadastrale Milloshev, Komuna e Obiliqit, gjendet një rrjedhë ujore sipërfaqësore. Sipas të dhënave të lokacionit, lumi ndodhet në distancë mbi 10 m nga zona ku realizohet projekti.

Prania e kësaj rrjedhe ujore duhet të merret parasysh gjatë planifikimit dhe operimit të aktivitetit, sidomos për shkak të natyrës së projektit që lidhet me grumbullimin dhe selektimin e mbeturinave të plastikës, letrës, qelqit dhe aluminit, si dhe me riciklimin e plastikës. Për këtë arsye, menaxhimi i materialeve dhe mbeturinave duhet të bëhet vetëm brenda hapësirave të kontrolluara të objektit dhe oborrit punues.

Projekti nuk parasheh shkarkim të drejtpërdrejtë të ujërave të ndotura në lumë apo në ndonjë trup tjetër ujor sipërfaqësor. Ujërat sanitare do të shkarkohen në sistemin ekzistues të kanalizimit, ndërsa ujërat që mund të krijohen nga pastrimi i hapësirave duhet të menaxhohen në mënyrë të kontrolluar, pa lejuar rrjedhjen e tyre drejt lumit.

Për shkak të afërsisë me rrjedhën ujore, duhet të zbatohen masa mbrojtëse si ruajtja e materialeve të riciklueshme në hapësira të mbyllura ose të kontrolluara, vendosja e mbeturinave në kontejnerë të veçantë, ndalimi i hedhjes së mbeturinave në ambient të hapur, pastrimi i rregullt i oborrit dhe parandalimi i shpërndarjes së plastikës, letrës apo materialeve të tjera nga era ose reshjet atmosferike.



Figura 10. distanca e objektit nga lumi

4. GJENDJA AKTUALE E FAKTORËVE MJEDISOR

4.1. Raport për gjendjen aktuale të faktorëve mjedisor

Bazuar në Planin Zhvillimor Komunal të Komunës së Obiliqit 2022–2030 dhe në dokumentet mjedisore komunale, gjendja aktuale e mjedisit në Komunën e Obiliqit është e ndikuar nga zhvillimet industriale, energjetike, infrastrukture, bujqësore dhe nga aktivitetet e përditshme të banorëve. Komuna e Obiliqit njihet si zonë me ngarkesë të theksuar mjedisore për shkak të pranisë së kapaciteteve energjetike, minierave, rrugëve, vendbanimeve dhe aktiviteteve ekonomike.

Cilësia e ajrit në territorin e komunës është një nga faktorët më të ndjeshëm mjedisorë. Burimet kryesore të ndikimit në ajër lidhen me aktivitetet energjetike dhe industriale në rajonin e Obiliqit, qarkullimin rrugor, përdorimin e lëndëve djegëse dhe aktivitetet ekonomike lokale. Në zonën e projektit, ndikimet e mundshme në ajër pritet të jenë më të kufizuara dhe lidhen kryesisht me qarkullimin e automjeteve, manipulimin me materiale të riciklueshme, pluhurin eventual dhe avujt/aromat e lehta gjatë përpunimit të plastikës.

Sa i përket ujërave, lokacioni i projektit ka furnizim me ujë dhe kanalizim, ndërsa në afërsi të parcelave gjendet një rrjedhë ujore sipërfaqësore në distancë mbi 10 m. Kjo kërkon kujdes të shtuar në menaxhimin e mbeturinave, pastrimin e hapësirave dhe parandalimin e rrjedhjes së ndotjeve drejt lumit. Projekti nuk parasheh shkarkim të ujërave teknologjike në lumë, ndërsa ujërat sanitare do të shkarkohen në sistemin ekzistues të kanalizimit.

Toka në lokacionin e projektit është e shfrytëzuar për objekt ekzistues dhe hapësirë pune, prandaj nuk parashihet humbje e tokës bujqësore për shkak të ndërtimit të ri. Ndikimet e mundshme në tokë mund të paraqiten vetëm në rast të menaxhimit jo të rregullt të mbeturinave, derdhjeve aksidentale ose shpërndarjes së materialeve në oborr. Për këtë arsye, materialet duhet të ruhen në hapësira të kontrolluara dhe mbeturinat e papërshtatshme duhet të dorëzohen te operatorët e licencuar.

Gjendja e zhurmës në zonë ndikohet kryesisht nga qarkullimi rrugor, aktivitetet ekonomike dhe objektet përreth. Gjatë funksionimit të projektit, zhurma mund të krijohet nga pajisjet për selektim, grimcim, ekstrudim, termoformim, kompresori i ajrit dhe automjetet transportuese. Duke qenë se aktiviteti zhvillohet brenda objektit të mbyllur, ndikimi i zhurmës pritet të jetë lokal dhe i menaxhueshëm me mirëmbajtje të rregullt të pajisjeve dhe organizim të mirë të punës.

Në aspektin e mbeturinave, projekti ka karakter pozitiv, pasi ka për qëllim grumbullimin, selektimin dhe riciklimin e materialeve të riciklueshme, si plastika, letra, qelqi dhe alumini.

Megjithatë, gjatë procesit mund të krijohen mbetje të papërshtatshme për riciklim, papastërti nga selektimi, ambalazhe të dëmtuara dhe mbeturina komunale nga punëtorët. Këto duhet të ndahen në burim, të ruhen në kontejnerë të veçantë dhe të dorëzohen te operatorët e licencuar. Biodiversiteti në lokacionin e projektit nuk pritet të ndikohet në mënyrë të theksuar, pasi aktiviteti do të zhvillohet në objekt ekzistues dhe në hapësirë tashmë të shfrytëzuar. Nuk parashihet ndërhyrje në habitate natyrore, prerje masive të vegjetacionit apo ndryshim i rrjedhave ujore. Masat kryesore duhet të fokusohen në mbajtjen e pastër të oborrit, parandalimin e shpërndarjes së plastikës dhe materialeve të lehta nga era, si dhe mbrojtjen e rrjedhës ujore afër lokacionit.

Në përgjithësi, faktorët mjedisorë në zonën e Obiliqit janë të ndikuar nga aktivitetet ekzistuese industriale dhe infrastrukturore. Projekti i propozuar pritet të ketë ndikime lokale dhe të menaxhueshme, me kusht që aktiviteti të zhvillohet brenda objektit, mbeturinat të menaxhohen në mënyrë të rregullt, të mos ketë shkarkime të pakontrolluara dhe të zbatohen masat për mbrojtjen e ajrit, ujit, tokës dhe shëndetit të banorëve përreth.

5. PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TË PROJEKTIT

5.1. Përshkrimi i alternativave të realizueshme

Gjatë planifikimit të projektit të kompanisë “Eco Recycling” SH.P.K. janë shqyrtuar alternativat e mundshme për zhvillimin e aktivitetit, duke marrë parasysh lokacionin, objektin ekzistues, qasjen në infrastrukturë, ndikimet e mundshme në mjedis dhe mënyrën e menaxhimit të mbeturinave të plastikës, letrës, qelqit dhe aluminit.:

- a) Alternativa kryesore e përzgjedhur është zhvillimi i projektit në objektin ekzistues në Zonën Kadastrale Milloshev, Komuna e Obiliqit, në ngastra kadastrale P-72614051-00116-0. Kjo alternativë vlerësohet si më e përshtatshme, pasi objekti është i ndërtuar dhe posedon qasje rrugore, furnizim me ujë, kanalizim dhe energji elektrike. Për këtë arsye, nuk kërkohet ndërtim i ri apo ndërhyrje e madhe në tokë.
- b) Alternativa tjetër e mundshme do të ishte ndërtimi i një objekti të ri në një lokacion tjetër. Kjo alternativë nuk është vlerësuar si më e favorshme, pasi do të kërkonte zënie të re të tokës, punime ndërtimore, ndërtim të infrastrukturës përcjellëse dhe ndikime më të mëdha gjatë fazës së ndërtimit.
- c) Është shqyrtuar edhe alternativa e zhvillimit vetëm të aktivitetit të grumbullimit dhe selektimit të mbeturinave të plastikës, letrës, qelqit dhe aluminit, pa riciklimin e plastikës dhe pa prodhimin e produkteve plastike. Kjo alternativë do të kishte ndikime më të vogla teknologjike, por do të kufizonte qëllimin e projektit, pasi plastika nuk do të përpunohej në lokacion dhe nuk do të kthehej në produkt të ri.

Alternativa e përzgjedhur përfshin grumbullimin dhe selektimin e mbeturinave të plastikës, letrës, qelqit dhe aluminit, riciklimin e plastikës dhe prodhimin e produkteve plastike përmes fletëve plastike dhe termoformimit. Kjo zgjidhje mundëson shfrytëzim më të mirë të mbeturinave të plastikës, zvogëlim të sasisë së mbeturinave që përfundojnë në deponi dhe zhvillim të aktivitetit brenda një objekti të kontrolluar.

Po ashtu është marrë parasysh edhe alternativa “pa projekt”, që nënkupton mosrealizimin e aktivitetit. Në këtë rast nuk do të kishte ndikime nga funksionimi i qendrës, por nuk do të arrihej përfitimi mjedisor nga grumbullimi, selektimi dhe riciklimi i mbeturinave të plastikës, letrës, qelqit dhe aluminit.

Duke marrë parasysh gjendjen ekzistuese të objektit, infrastrukturën e siguruar, mundësinë e kontrollit të procesit brenda hapësirës së mbyllur dhe përfitimet nga grumbullimi, selektimi

dhe riciklimi i mbeturinave të plastikës, letrës, qelqit dhe aluminit, alternativa e përzgjedhur konsiderohet si zgjidhja më e realizueshme dhe më e përshtatshme për këtë projekt.

5.2. Përshkrimi i alternativave të realizueshme përmban edhe përshkrimin e arsyeve kryesore për zgjedhjen e një alternative të caktuar duke ju referuar

Përshkrimi i alternativave të realizueshme përfshin edhe arsyet kryesore për zgjedhjen e alternativës së përzgjedhur. Kjo alternativë është zgjedhur duke iu referuar kushteve ekzistuese të lokacionit, faktit që objekti është i ndërtuar, qasjes së sigurtuar rrugore, furnizimit me ujë, kanalizimit dhe energjisë elektrike, si dhe mundësisë për zhvillimin e aktivitetit brenda një hapësire të kontrolluar.

Zgjedhja e kësaj alternative konsiderohet më e përshtatshme edhe nga aspekti mjedisor, pasi nuk kërkon ndërtim të ri, nuk shkakton zënie të re të tokës dhe mundëson menaxhimin më të mirë të mbeturinave të plastikës, letrës, qelqit dhe aluminit. Po ashtu, riciklimi i plastikës dhe prodhimi i produkteve plastike brenda objektit kontribuojnë në zvogëlimin e sasisë së mbeturinave që përfundojnë në deponi dhe në shfrytëzimin më racional të materialeve.

5.3. Vendndodhja ose rruga

Lokacioni i projektit ka qasje të përshtatshme rrugore përmes rrjetit ekzistues, duke mundësuar hyrjen dhe daljen e automjeteve transportuese gjatë fazës së ndërtimit dhe operimit. Kjo qasje e bën lokacionin të favorshëm për pranimin, transportin dhe menaxhimin e mbeturinave, pa pasur nevojë për ndërhyrje të mëdha në infrastrukturën rrugore ekzistuese.

5.4. Ndikimet në mjedis dhe shëndetin e njeriut

Meqenëse projekti është i ndërtuar, ndikimet mund të paraqiten gjatë fazës së operimit. Gjatë operimit ndikimet kryesore lidhen me qarkullimin e automjeteve, manipulimin me mbeturina, zhurmën dhe pluhurin. Projekti nuk parasheh djegie, trajtim termik apo trajtim kimik të mbeturinave. Me zbatimin e masave mbrojtëse, ndikimet në mjedis dhe shëndetin e njeriut vlerësohen si të menaxhueshme.

5.5. Proceset dhe teknologjia e prodhimit

Procesi teknologjik i projektit përfshin pranimin, grumbullimin dhe selektimin e mbeturinave të plastikës, letrës, qelqit dhe aluminit. Letra, qelqi dhe alumini selektohen, magazinohen përkohësisht dhe përgatiten për dorëzim te operatorët e licencuar.

Pjesa kryesore e prodhimit lidhet me riciklimin e plastikës. Plastika e përshtatshme kalon në selektim, grimeim, ekstrudim, filtrimi dhe granulim, ku shndërrohet në granulat plastik.

Granulati plastik më pas përdoret për prodhimin e fletëve plastike, të cilat përmes termoformimit nxehen, formohen me kallëpe dhe priten sipas produktit final. Mbetjet plastike të pastra nga prerja rikthehen përsëri në procesin e riciklimit.

Teknologjia e përzgjedhur nuk parasheh djegie të mbeturinave dhe nuk përfshin procese të rënda kimike. Procesi zhvillohet brenda objektit ekzistues dhe vlerësohet si i kontrollueshëm nga aspekti mjedisor.

5.6. Metodat e punës gjatë zbatimit dhe funksionimit të projektit

Gjatë zbatimit të projektit do të përdoren metoda të organizuara të punës, duke filluar me përshtatjen e objektit ekzistues, vendosjen e pajisjeve teknologjike dhe ndarjen e hapësirave sipas funksionit. Brenda objektit do të përcaktohen zonat për pranimin, selektimin, magazinimin, riciklimin e plastikës dhe prodhimin e produkteve plastike.

Gjatë funksionimit, puna do të zhvillohet në mënyrë të kontrolluar. Mbeturinat e plastikës, letrës, qelqit dhe aluminit do të pranohen, kontrollohen dhe ndahen sipas llojit. Letra, qelqi dhe alumini do të magazinohen përkohësisht dhe do të përgatiten për dorëzim te operatorët e licencuar.

Plastika e përshtatshme do të kalojë në procesin e riciklimit, përkatësisht në selektim, grimcim, ekstrudim, filtrimi dhe granulim. Granulati i prodhuar do të përdoret për prodhimin e fletëve plastike dhe produkteve plastike përmes termoformimit.

Gjatë punës do të zbatohen metoda për mbajtjen e pastër të hapësirës, grumbullimin e mbetjeve në kontejnerë të veçantë, rikthimin e mbetjeve plastike të pastra në proces dhe dorëzimin e mbeturinave të papërshtatshme te operatorët e licencuar.

Punëtorët do të punojnë sipas udhëzimeve teknike dhe masave të sigurisë në punë. Pajisjet do të mirëmbahen rregullisht, ndërsa procesi do të zhvillohet pa djegie të mbeturinave dhe pa përdorim të proceseve të rënda kimike.

5.7. Plani i lokacionit

Brenda lokacionit do të organizohen hapësirat për pranimin dhe selektimin e mbeturinave, magazinimin e përkohshëm të letrës, qelqit dhe aluminit, linjën për riciklimin e plastikës, linjën për prodhimin e fletëve plastike me termoformim, magazinimin e granulit dhe produkteve plastike, si dhe hapësirat për mbeturinat që nuk janë të përshtatshme për riciklim.

Objekti është ekzistues dhe nuk parashihet ndërtim i ri jashtë hapësirës së projektit. Lokacioni ka infrastrukturën e nevojshme, duke përfshirë rrugën, energjinë elektrike, ujësjellësin dhe kanalizimin. Plani i lokacionit shërben për të treguar organizimin hapësinor të projektit dhe ndërlidhjen e tij me rrugën, parcelat fqinje dhe objektet përreth.

5.8. Llojin dhe përzgjedhjen e materialeve për realizimin e projektit

Për realizimin e projektit do të përdoren materiale dhe pajisje të përshtatshme për grumbullimin, selektimin, riciklimin e plastikës dhe prodhimin e produkteve plastike. Meqenëse projekti zhvillohet në objekt ekzistues, nuk parashihet përdorim i madh i materialeve ndërtimore, përveç atyre që mund të nevojiten për përshtatje teknike të hapësirës.

Materialet kryesore të projektit janë mbeturinat e plastikës, letrës, qelqit dhe aluminit, të cilat do të pranohen, selektohen dhe menaxhohen sipas llojit. Letra, qelqi dhe alumini do të magazinohen përkohësisht dhe do të përgatiten për dorëzim te operatorët e licencuar.

Për procesin e riciklimit do të përdoret plastika e përshtatshme për përpunim, e cila pas selektimit kalon në grimcim, ekstrudim, filtrimi dhe granulim. Granulati plastik i prodhuar do të përdoret si lëndë e parë për prodhimin e fletëve plastike dhe produkteve finale përmes termoformimit.

Për funksionimin e linjave do të përdoren pajisje teknologjike, si pajisjet për selektim, grimcim, ekstrudim, granulim, prodhim të fletëve plastike, termoformim dhe prerje. Gjithashtu do të përdoren kontejnerë për mbeturina, paleta, ambalazhe për paketim, pajisje për magazinim dhe mjete mbrojtëse për punëtorët.

Përzgjedhja e materialeve dhe pajisjeve do të bëhet duke marrë parasysh sigurinë në punë, qëndrueshmërinë teknike, mundësinë e mirëmbajtjes dhe ndikimin sa më të ulët në mjedis. Nuk parashihet përdorim i materialeve të rrezikshme apo substancave kimike të rënda në procesin teknologjik.

5.9. Afati kohor për ekzekutimin dhe përfundimin e funksionimit të projektit sipas legjislacionit

Afati i parashikuar për përgatitjen, montimin dhe testimin e pajisjeve është rreth 1 deri në 3 muaj, varësisht nga kushtet teknike në objekt, furnizimi me pajisje dhe përfundimi i procedurave administrative. Fillimi i funksionimit të rregullt do të bëhet vetëm pas pajisjes me pëlqimet, lejet dhe licencat e nevojshme, sipas legjislacionit në fuqi.

5.10. Madhësia e lokacionit ose objektit

Sipërfaqja e përgjithshme e tokës së projektit është 8169 m², ndërsa objekti ekzistues ku do të zhvillohet aktiviteti ka sipërfaqe prej 2390.95 m². Objekti do të shfrytëzohet për grumbullimin dhe selektimin e mbeturinave të plastikës, letrës, qelqit dhe aluminit, si dhe për riciklimin e plastikës dhe prodhimin e produkteve plastike.

5.11. Vëllimi i prodhimit

Vëllimi i prodhimit për projektin e kompanisë “Eco Recycling” SH.P.K. do të varet nga sasia e mbeturinave të plastikës, letrës, qelqit dhe aluminit që pranoen në qendër, cilësia e materialit të pranuar, kapaciteti i pajisjeve dhe kërkesat e tregut për produkte plastike sipas kapaciteteve operative të qendrës.

Pjesa kryesore e prodhimit lidhet me riciklimin e plastikës. Linja për riciklimin e plastikës ka kapacitet të planifikuar rreth **2 ton/orë**, varësisht nga lloji dhe pastërtia e materialit plastik. Nga ky proces prodhohet granulat plastik, i cili mund të përdoret si lëndë e parë për prodhimin e fletëve plastike ose të magazinohet për shitje.

5.12. Kontrolli i ndotjes

Kontrolli i ndotjes gjatë funksionimit të projektit të kompanisë “Eco Recycling” SH.P.K. do të bëhet përmes masave teknike dhe organizative për mbrojtjen e ajrit, ujit, tokës dhe shëndetit të njeriut.

Proceset e riciklimit të plastikës, prodhimit të fletëve plastike dhe termoformimit do të zhvillohen brenda objektit të mbyllur. Objekti duhet të ketë ventilim të përshtatshëm, ndërsa pajisjet duhet të mirëmbahen rregullisht për të zvogëluar pluhurin, aromat dhe zhurmën gjatë punës. Në lokacion nuk parashihet djegie e mbeturinave.

Mbeturinat e plastikës, letrës, qelqit dhe aluminit do të ndahen sipas llojit dhe do të ruhen në hapësira të kontrolluara. Mbetjet që nuk janë të përshtatshme për riciklim do të vendosen në kontejnerë të veçantë dhe do të dorëzohen te operatorët e licencuar.

Ujërat sanitare do të shkarkohen në sistemin ekzistues të kanalizimit, ndërsa nuk lejohet shkarkimi i ujërave të ndotura ose hedhja e mbeturinave në tokë, në lumë apo në hapësira të hapura.

5.13. Trajtimin e mbeturinave, përfshirë riciklimin, ripërdorimin, asgjësimin dhe deponimin përfundimtar

Trajtimi i mbeturinave në kuadër të projektit të kompanisë “Eco Recycling” SH.P.K. do të bëhet përmes grumbullimit, selektimit, riciklimit, ripërdorimit dhe dorëzimit të mbetjeve të papërshtatshme te operatorët e licencuar.

Mbeturinat e plastikës do të selektohen dhe materiali i përshtatshëm do të kalojë në procesin e riciklimit, përmes grumbullimit, ekstrudimit, filtrimit dhe granulimit. Granulati plastik i prodhuar do të përdoret si lëndë e parë për prodhimin e fletëve plastike dhe produkteve plastike përmes termoformimit.

Mbetjet plastike të pastra që krijohen gjatë prerjes dhe termoformimit do të rikthehen përsëri në proces, duke mundësuar ripërdorimin e materialit dhe zvogëlimin e sasisë së mbeturinave që duhet të largohen nga objekti.

Mbeturinat e letrës, qelqit dhe aluminit do të selektohen, do të ruhen përkohësisht në hapësira të veçanta dhe do të përgatiten për dorëzim te operatorët e licencuar ose subjektet që merren me riciklimin e tyre. Këto materiale nuk do të përpunohen industrialisht në lokacion.

Mbeturinat që nuk janë të përshtatshme për riciklim, si papastërtitë nga selektimi, materialet e kontaminuara dhe mbeturinat komunale, do të grumbullohen në kontejnerë të veçantë dhe do të dorëzohen te operatorët e licencuar për trajtim, asgjësim ose deponim përfundimtar.

Në lokacion nuk parashihet djegie, hedhje e pakontrolluar apo deponim përfundimtar i mbeturinave. Deponimi përfundimtar do të bëhet vetëm për mbetjet që nuk mund të riciklohen, përmes subjekteve të autorizuar dhe në përputhje me kërkesat ligjore.

5.14. Rregullimi i infrastrukturës rrugore të qasjes në projekt dhe rrugë të komunikacioni

Lokacioni i projektit ka qasje përmes rrjetit ekzistues rrugor, i cili mundëson hyrjen dhe daljen e mjeteve transportuese. Qasja rrugore është e rëndësishme për furnizimin me materiale për pranimin dhe transportin e mbeturinave gjatë operimit të qendrës.

5.15. Përgjegjësia dhe procedurat për menaxhimin e mjedisit

Në nivel organizativ, kompania cakton person përgjegjës për mjedisin, i cili koordinon zbatimin e masave mjedisore, mbikëqyr procedurat e menaxhimit të mbeturinave, kujdeset për evidencat dhe dokumentacionin, si dhe siguron komunikim me autoritetet kompetente kur kërkohet. Përgjegjësia për zbatimin praktik të masave ndahet edhe me udhëheqësin operativ të lokacionit dhe me personelin që punon në pranimin, seleksionimin dhe magazinimin, ku secili ka detyrime të përcaktuara për rend, pastërti, siguri dhe shmangie të veprimeve që mund të shkaktojnë ndotje. Procedurat kryesore për menaxhimin e mjedisit përfshijnë kontrollin e pranimit të mbeturinave, ku pranohen vetëm mbeturina të lejuara, si dhe kryhet kontroll vizual për të identifikuar materiale të paautorizuara. Parashihet peshimi dhe regjistrimi i çdo ngarkese hyrëse dhe dalëse, me qëllim gjurmueshmërinë e sasive dhe kontrollin e stokut.

5.16. Trajnimi

Stafi trajnohet për sigurinë në punë, menaxhimin e mbeturinave, mbrojtjen mjedisore dhe reagimin në raste emergjente.

5.17. Monitorimi

Monitorimi do të zbatohet gjatë fazës së funksionimit të qendrës, me qëllim që të sigurohet respektimi i masave të përcaktuara në Raportin e VNM-së dhe kushteve ligjore. Gjatë funksionimit do të monitorohen menaxhimi i mbeturinave, pastërtia e hapësirave operative, zhurma, pluhuri, gjendja e pajisjeve dhe çdo rrezik i mundshëm për ndotje të tokës apo ujërave.

5.18. Planet për situata emergjente

Për projektin do të parashihen plane për reagim në raste emergjente, si zjarr, aksidente në punë, rrjedhje aksidentale të vajrave apo karburanteve, defekte teknike dhe situata të tjera të papritura. Qendra do të pajiset me mjete kundër zjarrit, materiale absorbuese, pajisje mbrojtëse personale dhe udhëzime për veprim në raste emergjente.

5.19. Demolimi dhe rehabilitimi

Në rast se në të ardhmen aktiviteti ndërpritet, do të bëhet çmontimi i pajisjeve për grumbullim, selektim, riciklim të plastikës dhe prodhim të produkteve plastike. Pajisjet që mund të ripërdoren do të largohen nga lokacioni, ndërsa pjesët e dëmtuara ose të papërdorshme do të dorëzohen te operatorët e licencuar.

Pas ndërprerjes së aktivitetit, objekti dhe hapësira përreth duhet të pastrohen nga mbeturinat e plastikës, letrës, qelqit, aluminit, mbetjet e papërshtatshme dhe materialet e tjera të mbetura. Nuk lejohet lënia e mbeturinave në oborr, në tokë, afër rrjedhës ujore apo në hapësira të hapura. Rehabilitimi i lokacionit do të përfshijë pastrimin e sipërfaqeve të punës, largimin e kontejnerëve dhe materialeve të mbetura, kontrollimin e dyshemeve dhe hapësirave të magazinimit, si dhe kthimin e objektit në gjendje të sigurt për përdorim tjetër.

Meqenëse projekti zhvillohet në objekt ekzistues dhe nuk parasheh ndërhyrje të madhe në tokë, rehabilitimi pritet të jetë i kufizuar dhe i menaxhueshëm. Qëllimi kryesor është që pas përfundimit të aktivitetit lokacioni të mbetet i pastër, i sigurt dhe pa rrezik për ndotjen e tokës, ujërave, ajrit apo shëndetit të njeriut.

5.20. Plani për menaxhimin e mjedisit

Plani për menaxhimin e mjedisit përfshin masat parandaluese, monitoruese dhe korrigjuese për zvogëlimin e ndikimeve gjatë funksionimit të qendrës. Ky plan përfshin kontrollin e pluhurit dhe zhurmës, menaxhimin e mbeturinave, mbrojtjen e tokës dhe ujërave, mirëmbajtjen e pajisjeve, trajnimin e stafit dhe reagimin në raste emergjente.

5.21. Përshkrimi i alternativës pa veprim

Alternativa pa veprim nënkupton mosrealizimin e projektit për ndërtimin dhe funksionimin e qendrës.

6. PËRSHKRIMI I NDIKIMIT TË PROJEKTIT NË MJEDIS

6.1. Përshkrimi i ndikimeve të projektit në mjedis përfshinë:

Përshkrimi i ndikimeve të projektit në mjedis përfshin identifikimin dhe vlerësimin e ndikimeve të mundshme që mund të paraqiten gjatë funksionimit të qendrës për grumbullimin dhe selektimin e mbeturinave të plastikës, letrës, qelqit dhe aluminit, si dhe gjatë riciklimit të plastikës dhe prodhimit të produkteve plastike.

Në këtë kapitull trajtohen ndikimet e mundshme në ajër, ujë, tokë, zhurmë, mbeturina, biodiversitet, peizazh, shëndetin e njeriut dhe sigurinë në punë. Po ashtu, vlerësohen ndikimet nga qarkullimi i automjeteve, funksionimi i pajisjeve teknologjike, magazinimi i materialeve dhe menaxhimi i mbetjeve që krijohen gjatë procesit.

6.2. Cilësinë e ajrit

Ndikimi i projektit në cilësinë e ajrit pritet të jetë i kufizuar dhe lokal. Aktiviteti do të zhvillohet kryesisht brenda objektit ekzistues, ku do të bëhet grumbullimi dhe selektimi i mbeturinave të plastikës, letrës, qelqit dhe aluminit, si dhe riciklimi i plastikës dhe prodhimi i produkteve plastike.

Burimet kryesore të ndikimit në ajër mund të jenë qarkullimi i automjeteve gjatë sjelljes së mbeturinave dhe largimit të produkteve ose materialeve të selektuara, pluhuri i lehtë gjatë manipulimit me materiale, si dhe pluhuri që mund të krijohet gjatë grimcimit të plastikës. Po ashtu, gjatë ekstrudimit dhe termoformimit mund të paraqiten aroma të lehta nga ngrohja e materialit plastik.

Në lokacion nuk parashihet djegie e mbeturinave dhe nuk do të zhvillohen procese kimike të rënda, prandaj nuk priten emetime të mëdha në ajër. Proceset teknologjike do të zhvillohen në kushte të kontrolluara, me ventilim të përshtatshëm dhe me mirëmbajtje të rregullt të pajisjeve. Për zvogëlimin e ndikimeve në cilësinë e ajrit, hapësirat e punës duhet të mbahen të pastra, mbeturinat të ruhen në mënyrë të kontrolluar, plastika e lehtë të mos shpërndahet në oborr dhe pajisjet të kontrollohen rregullisht. Me zbatimin e këtyre masave, ndikimi në cilësinë e ajrit pritet të jetë i ulët dhe i menaxhueshëm.

6.3. Nivelin dhe përqendrimin e substancave ndotëse në ajër dhe krahasimin me treguesit e përcaktuar me norma dhe standardet sipas legjislacionit në fuqi

Vlerësimi i cilësisë së ajrit bëhet duke marrë parasysh ndotësit kryesorë që monitorohen në Kosovë, si PM10, PM2.5, SO₂, NO₂, CO dhe O₃. Këta parametra monitorohen nga rrjeti shtetëror i monitorimit të cilësisë së ajrit, ku përfshihen edhe stacionet në zonën e Obiliqit dhe rrethinës industriale.

Për lokacionin e projektit nuk janë kryer matje specifike të përqendrimeve të ndotësve në ajër. Megjithatë, duke marrë parasysh karakterin e aktivitetit, nuk pritet që projekti të shkaktojë tejkalim të normave të lejuara për cilësinë e ajrit. Aktiviteti nuk parasheh djegie të mbeturinave, nuk përfshin procese kimike të rënda dhe nuk përdor lëndë djegëse në procesin teknologjik.

Burimet kryesore të mundshme të ndotjes së ajrit nga projekti janë pluhuri i lehtë gjatë manipulimit dhe grimcimit të plastikës, qarkullimi i automjeteve transportuese, si dhe aromat ose avujt e lehtë gjatë ekstrudimit dhe termoformimit. Këto ndikime pritet të jenë lokale dhe të kufizuara, pasi proceset zhvillohen brenda objektit të mbyllur dhe kontrollohen përmes ventilimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve.

6.4. Ndikimi i projektit në klimë, lloji dhe vëllimi i emetimeve të gazeve serrë dhe ndjeshmëria e projektit ndaj ndryshimeve klimatike

Projekti nuk pritet të ketë ndikim të rëndësishëm në klimë, pasi nuk përfshin procese industriale me emetime të mëdha të gazeve serrë. Emetimet e mundshme do të vijnë kryesisht nga automjetet transportuese dhe makineritë që përdoren. Këto emetime do të jenë të kufizuara dhe të lidhura me intensitetin e punës dhe qarkullimin e automjeteve. Në anën tjetër, projekti ka ndikim pozitiv indirekt në aspektin klimatik, pasi përmes riciklimit ndihmon në zvogëlimin e sasisë së mbeturinave që përfundojnë në deponi dhe mbështet përdorimin më efikas të materialeve. Sa i përket ndjeshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike, projekti duhet të marrë parasysh menaxhimin e ujërave atmosferike, reshjet intensive dhe mbrojtjen e hapësirave operative nga grumbullimi i ujit. Me projektim dhe mirëmbajtje të duhur të infrastrukturës, ndjeshmëria e projektit ndaj ndryshimeve klimatike vlerësohet e ulët.

6.5. Mundësinë e ndikimit në ndotjen ndërkuftare të ajrit

Duke marrë parasysh natyrën dhe përmasat e projektit, nuk pritet ndikim në ndotjen ndërkuftare të ajrit. Aktiviteti do të zhvillohet në nivel lokal dhe nuk përfshin procese që gjenerojnë emetime të mëdha apo të shpërndara në distanca të gjata.

6.6. Cilësia e ujit

Ndikimi i projektit në cilësinë e ujit pritet të jetë i kufizuar, me kusht që aktiviteti të zhvillohet brenda objektit ekzistues dhe mbeturinat të menaxhohen në mënyrë të kontrolluar. Projekti nuk parasheh shkarkim të drejtpërdrejtë të ujërave të ndotura në lumë, tokë apo kanale të hapura. Në afërsi të lokacionit gjendet një rrjedhë ujore në distancë mbi 10 m, prandaj gjatë funksionimit duhet të ketë kujdes të veçantë që mbeturinat e plastikës, letrës, qelqit dhe aluminit të mos shpërndahen në oborr dhe të mos barten nga reshjet atmosferike drejt lumit.

Uji do të përdoret kryesisht për nevoja sanitare të punëtorëve, pastrim të hapësirave të punës dhe sipas nevojës për procese teknike ndihmëse. Ujërat sanitare do të shkarkohen në sistemin ekzistues të kanalizimit, ndërsa ujërat nga pastrimi duhet të menaxhohen në mënyrë të kontrolluar.

Rreziku kryesor për cilësinë e ujit mund të paraqitet në rast të menaxhimit jo të rregullt të mbeturinave, derdhjeve aksidentale, shpërndarjes së materialeve të lehta nga era ose reshjet, si dhe pastrimit të pakontrolluar të hapësirave të punës.

Për mbrojtjen e cilësisë së ujit, mbeturinat duhet të ruhen në hapësira të mbyllura ose të kontrolluara, kontejnerët të jenë të vendosur në sipërfaqe të përshtatshme, oborri të pastrohet rregullisht dhe të mos lejohet hedhja e mbeturinave apo ujërave të ndotura në rrjedhën ujore.

6.7. Ndikimi i ndotësve në cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore

Ndikimi i mundshëm në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore lidhet kryesisht me menaxhimin e mbeturinave të plastikës, letrës, qelqit dhe aluminit brenda lokacionit. Projekti nuk parasheh shkarkim të drejtpërdrejtë të ujërave të ndotura në lumë, tokë apo kanale të hapura.

Në afërsi të lokacionit gjendet një rrjedhë ujore në distancë mbi 10 m, prandaj duhet të parandalohet bartja e mbeturinave, pluhurit, plastikës së lehtë apo ujërave nga pastrimi drejt kësaj rrjedhe. Rreziku mund të paraqitet vetëm në rast të ruajtjes së pakontrolluar të mbeturinave në oborr, shpërndarjes së materialeve nga reshjet ose derdhjeve aksidentale.

Ndikimi në ujërat nëntokësore pritet të jetë i ulët, pasi aktiviteti zhvillohet kryesisht brenda objektit ekzistues dhe nuk parashihet deponim i mbeturinave në tokë. Ujërat sanitare do të shkarkohen në sistemin ekzistues të kanalizimit, ndërsa ujërat nga pastrimi duhet të menaxhohen në mënyrë të kontrolluar.

6.8. Mundësinë e ndikimit në ndotjen ndërkuftare të ujërave

Për shkak të natyrës së aktivitetit dhe menaxhimit të kontrolluar, nuk pritet ndonjë ndikim në ndotjen ndërkuftare të ujërave. Aktivitetet do të zhvillohen brenda lokacionit të projektit, duke shmangur çdo mundësi të ndikimeve negative për ujërat përreth.

6.9. Ndryshimet hidromorfologjike, sasia dhe cilësia me referencë të vecantë për shkarkimet e ujërave të zeza

Projekti i kompanisë “Eco Recycling” SH.P.K. nuk parasheh ndërhyrje në shtratin e lumit, devijim të rrjedhës ujore, ndërtim të urave, kanaleve të reja apo ndryshim të formës natyrore të rrjedhës ujore në afërsi të lokacionit. Për këtë arsye, nuk priten ndryshime hidromorfologjike në rrjedhën ujore që gjendet mbi 10 m nga zona e projektit..

6.10. Toka

Ndikimi i projektit në tokë pritet të jetë i ulët, pasi aktiviteti do të zhvillohet në objekt ekzistues dhe nuk parashihet ndërtim i ri apo ndërhyrje e madhe në sipërfaqen e tokës. Lokacioni tashmë është i shfrytëzuar për objekt dhe hapësirë pune, prandaj nuk pritet humbje e tokës bujqësore apo ndryshim i madh i përdorimit të saj.

Rreziku kryesor për ndotjen e tokës mund të paraqitet në rast të menaxhimit jo të rregullt të mbeturinave të plastikës, letrës, qelqit dhe aluminit, shpërndarjes së materialeve në oborr, ose derdhjeve aksidentale gjatë pastrimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve.

6.11. Ndikimi fizik, ndryshimi në topografinë lokale, erozioni i tokës, rrëshqitjet e tokës

Ndikimi fizik i projektit në lokacion pritet të jetë i ulët, pasi aktiviteti i kompanisë “Eco Recycling” SH.P.K. do të zhvillohet në objekt ekzistues dhe nuk parashihet ndërtim i ri, gjurmime të mëdha apo ndërhyrje në terrenin natyror. Për këtë arsye, nuk pritet ndryshim i dukshëm në topografinë lokale.

Punët përgatitore do të kufizohen kryesisht në organizimin e hapësirës së brendshme, vendosjen e pajisjeve teknologjike dhe përshtatjen e objektit për grumbullim, selektim, riciklim të plastikës dhe prodhim të produkteve plastike. Këto aktivitete nuk paraqesin rrezik për ndryshim të relievit apo dëmtim të strukturës së tokës.

Rreziku nga erozioni i tokës dhe rrëshqitjet e tokës vlerësohet si shumë i ulët, pasi lokacioni është i shfrytëzuar dhe aktiviteti zhvillohet në hapësirë të ndërtuar. Nuk parashihet largim i shtresës së tokës, hapje e pjerrësive të reja apo punime që mund të shkaktojnë destabilizim të terrenit.

6.12. Ndikimi i emetimeve të ndotësve në vendndodhjen e projektit dhe në tokën përreth dhe krahasimi me treguesit e përcaktuar me norma dhe standarde sipas legjislacionit përkatës

Ndikimi i emetimeve të ndotësve në tokën e lokacionit dhe në tokën përreth pritet të jetë i ulët, pasi projekti do të zhvillohet në objekt ekzistues dhe nuk parashihet procese që shkaktojnë shkarkime të drejtpërdrejta në tokë. Aktiviteti kryesor lidhet me grumbullimin, selektimin e mbeturinave të plastikës, letrës, qelqit dhe aluminit, si dhe riciklimin e plastikës dhe prodhimin e produkteve plastike.

Burimet e mundshme të ndikimit në tokë mund të jenë shpërndarja e mbeturinave në oborr, pluhuri i lehtë gjatë manipulimit me materiale, mbetjet nga selektimi, si dhe derdhjet

aksidentale gjatë pastrimit ose mirëmbajtjes së pajisjeve. Këto ndikime mund të paraqiten vetëm në rast të menaxhimit jo të rregullt të materialeve dhe mbeturinave.

6.13. Ndikimi në shfrytëzimin e tokës dhe burimeve natyrore

Ndikimi i projektit në shfrytëzimin e tokës pritet të jetë i ulët, pasi aktiviteti do të zhvillohet në objekt ekzistues në Zonën Kadastrale Milloshev, Komuna e Obiliqit. Nuk parashihet ndërtim i ri, zgjerim i madh i sipërfaqes apo zënie shtesë e tokës për nevoja të projektit.

Sipërfaqja e tokës së lokacionit është 8169 m², ndërsa objekti ekzistues ka sipërfaqe 2390.95 m². Objekti do të përdoret për grumbullimin dhe selektimin e mbeturinave të plastikës, letrës, qelqit dhe aluminit, si dhe për riciklimin e plastikës dhe prodhimin e produkteve plastike. Pjesa tjetër e lokacionit do të shfrytëzohet për qasje, lëvizje të automjeteve, hapësira punuese dhe magazinim të kontrolluar.

Projekti nuk parasheh shfrytëzim të drejtpërdrejtë të burimeve natyrore si gurë, zhavorr, minerale, pyje apo toka të reja bujqësore. Burimi kryesor që përdoret në proces është mbeturina e plastikës, letrës, qelqit dhe aluminit, e cila trajtohet si material për riciklim dhe ripërdorim. Përdorimi i ujit do të jetë i kufizuar, kryesisht për nevoja sanitare, pastrim dhe eventualisht për nevoja teknike të pajisjeve. Furnizimi me ujë bëhet nga rrjeti ekzistues i ujësjellësit dhe nuk parashihet hapja e puseve apo shfrytëzimi i burimeve natyrore ujore.

Nga aspekti mjedisor, projekti ka ndikim pozitiv në shfrytëzimin e burimeve, pasi përmes riciklimit të plastikës dhe selektimit të materialeve të tjera zvogëlohet nevoja për përdorimin e lëndëve të para të reja dhe ulët sasia e mbeturinave që përfundojnë në deponi.

Meqenëse projekti zhvillohet në objekt ekzistues dhe bazohet në ripërdorimin e mbeturinave të riciklueshme, ndikimi në shfrytëzimin e tokës dhe burimeve natyrore vlerësohet si i ulët dhe i menaxhueshëm.

6.14. Sasia dhe cilësia e tokës bujqësore të humbur

Gjithsej sipërfaqja e parcelës është 8169 m², e cila është kullosë e klasës I, objekti i ndërtuar është me sipërfaqe 2390.95 m².

6.15. Ndikimi në karakteristikat gjeologjike dhe geomorfologjike

Projekti nuk do të ketë ndikim të rëndësishëm në karakteristikat gjeologjike dhe geomorfologjike të zonës, pasi lokacioni është në një zonë të qëndrueshme nga këndvështrimi gjeologjik dhe nuk ka procese të natyrshme që mund të preken nga aktivitetet e projektit.

Ndërhyrjet në tokë do të jenë të kufizuara dhe do të realizohen pa ndryshuar strukturën gjeologjike dhe gjeomorfologjike të zonës.

6.16. Popullsia lokale

Projekti nuk pritet të ketë ndikime të rëndësishme në popullsinë lokale. Lokacioni ndodhet jashtë zonave të dendur të banuara dhe aktiviteti do të zhvillohet në një hapësirë të përshtatshme dhe të izoluar. Ndikimet në numrin e popullsisë dhe strukturën e saj do të jenë të kufizuara dhe nuk parashikohet të ketë migrim ose ndryshime në përqendrimin e popullsisë.

6.17. Ndryshimet në numrin dhe strukturën e popullsisë dhe ndikimet të lidhura me popullsinë, përqendrimi dhe migrimi

Projekti nuk do të shkaktojë ndryshime të dukshme në strukturën demografike të zonës. Aktiviteti është i natyrës industriale dhe nuk ka ndikim të drejtpërdrejtë në migrim ose përqendrimin e popullsisë.

6.18. Ndikimet vizuale të vendbanimeve

Duke qenë se projekti do të zhvillohet jashtë zonave të dendur të banuara, ndikimi vizual do të jetë i kufizuar. Masat për menaxhimin e ndikimeve vizuale do të merren për të siguruar që infrastruktura e re të përshtatet sa më mirë me mjedisin.

6.19. Ndikimet e emetimeve të ndotësve, zhurmës, vibrimeve, nxehhtësisë dhe të gjitha llojet e rrezatimit për shëndetin e njeriut

Gjatë fazës së operimit, ndikimet kryesore do të lidhen me lëvizjen e automjeteve dhe makinerive, të cilat mund të shkaktojnë pluhur dhe zhurmë. Ndikimi në shëndetin e njeriut do të jetë i menaxhueshëm përmes masave parandaluese dhe menaxhimit të duhur të ambientit.

6.20. Ndikimet socio-ekonomike

Projekti do të sjellë përfitime socio-ekonomike për zonën përreth duke krijuar mundësi pune dhe stimulimin e zhvillimit të aktiviteteve industriale dhe ekonomike. Nuk parashikohen ndikime negative në strukturën socio-ekonomike të zonës.

6.21. Ndikimi në strukturën dhe ekonominë lokale, sipas sektorëve prodhues dhe degëve kryesore të zonës

Projekti do të kontribuojë në zhvillimin e ekonomisë lokale, përfshirë sektorët e riciklimit, shërbimeve dhe industrisë. Nuk pritet të ketë ndikime negative në sektorët e tjerë të ekonomisë lokale.

6.22. Numri i vendeve të punës të krijuara gjatë fazave të ndërtimit dhe funksionimit të projektit, si dhe humbjet e mundshme të vendeve të punës në sektorët apo zonat e tjera

Objekti tashme është i ndërtuar ndërsa gjatë fazës së operimit, projekti do të krijojë mundësi të reja punësimi, si për staf të përkohshëm ashtu edhe për punëtorë të qëndrueshëm. Nuk pritet të ketë humbje të vendeve të pune në sektorët përreth.

6.23. Kontributi i projektit në ekonominë rajonale dhe kombëtare

Projekti do të kontribuojë në ekonominë rajonale dhe kombëtare përmes krijimit të mundësive të reja punësimi, rritjes së riciklimit dhe zvogëlimit të mbeturinave që përfundojnë në deponi, duke mbështetur përparimin e ekonomisë vendore.

6.24. Ekosistemet dhe gjeologjia

Ndikimi i projektit në ekosisteme pritet të jetë i ulët, pasi aktiviteti do të zhvillohet në objekt ekzistues dhe nuk parashihet ndërhyrje në habitate natyrore, prerje e vegjetacionit apo ndryshim i sipërfaqeve të gjelbra. Lokacioni është hapësirë tashmë e shfrytëzuar për objekt dhe aktivitet pune.

Në afërsi të lokacionit gjendet një rrjedhë ujore, prandaj duhet të parandalohet shpërndarja e mbeturinave të plastikës, letrës, qelqit dhe aluminit drejt saj. Me ruajtjen e materialeve në hapësira të kontrolluara dhe pastrimin e rregullt të oborrit, ndikimi në ekosistemet përreth pritet të jetë i menaxhueshëm.

Sa i përket gjeologjisë, projekti nuk parasheh gërmime, eksploatim të materialeve natyrore apo ndryshim të strukturës së tokës. Për këtë arsye, nuk priten ndikime të rëndësishme në përbërjen gjeologjike të lokacionit apo në stabilitetin e terrenit.

6.25. Humbja dhe dëmtimi i specieve bimore dhe shtazore dhe habitateve të tyre

Në kuadër të projektit, nuk priten humbje të specieve bimore dhe shtazore. Aktiviteti zhvillohet në një zonë ku habitati natyror është i kufizuar dhe nuk ka biodiversitet të veçantë që mund të rrezikohet nga ndërtimi i qendrës.

6.26. Humbja dhe dëmtimi i veçorive gjeologjike, paleontologjike dhe gjeomorfologjike, biodiversitetit, florës dhe faunës, pasurive natyrore të mbrojtura, specieve të ralla dhe të rrezikuara të bimëve dhe kafshëve dhe habitateve të tyre

Ndikimi i projektit në veçoritë gjeologjike, paleontologjike dhe gjeomorfologjike pritet të jetë i ulët, pasi aktiviteti do të zhvillohet në objekt ekzistues dhe nuk parashihet germim, eksploitim i materialeve natyrore apo ndryshim i relievit të lokacionit.

Projekti nuk parasheh prerje të vegjetacionit, ndërhyrje në zona natyrore apo ndryshim të përdorimit të sipërfaqeve me rëndësi ekologjike.

Nuk janë evidentuar pasuri natyrore të mbrojtura, specie të rralla apo të rrezikuara të florës dhe faunës brenda parcelave të projektit. Ndikimi i mundshëm në biodiversitet mund të paraqitet vetëm në rast të shpërndarjes së mbeturinave në hapësirën përreth ose bartjes së tyre drejt rrjedhës ujore që gjendet në afërsi.

6.27. Oëllimi dhe shfrytëzimi i sipërfaqeve

Lokacioni i projektit të kompanisë “Eco Recycling” SH.P.K. do të shfrytëzohet për grumbullimin dhe selektimin e mbeturinave të plastikës, letrës, qelqit dhe aluminit, si dhe për riciklimin e plastikës dhe prodhimin e produkteve plastike. Aktiviteti do të zhvillohet në objekt ekzistues, në Zonën Kadastrale Milloshev, Komuna e Obiliqit..

6.28. Sipërfaqet e ndërtuara dhe të pa ndërtuara

Sipërfaqja e përgjithshme e tokës është 14,772 m², ndërsa sipërfaqja e objektit ekzistues është 1,900 m². Pjesa e ndërtuar do të përdoret për vendosjen e pajisjeve teknologjike, selektimin, riciklimin e plastikës, prodhimin dhe magazinimin. Sipërfaqet e pandërtuara do të shfrytëzohen për qasje, qarkullim të automjeteve, vendosje të kontejnerëve dhe organizim të hapësirës punuese..

6.29. Shfrytëzimi i tokës

Shfrytëzimi i tokës nuk pritet të ndryshojë në mënyrë të theksuar, pasi projekti zhvillohet në objekt ekzistues dhe nuk parashihet ndërtim të ri apo zgjerim të madh të sipërfaqes së ndërtuar. Nuk pritet humbje e tokës bujqësore apo ndërhyrje në sipërfaqe natyrore.

6.30. Infrastrukturë komunale

Lokacioni posedon infrastrukturën e nevojshme komunale për zhvillimin e aktivitetit. Qasja rrugore është e siguar, po ashtu ekziston furnizimi me ujë, kanalizimi dhe energjia elektrike.

Për këtë arsye, projekti nuk kërkon ndërtim të infrastrukturës së re komunale jashtë lokacionit ekzistues.

6.31. Trafiku

Projekti ka qasje të drejtpërdrejtë në rrugët ekzistuese, që sigurojnë hyrje dhe dalje të sigurt për mjete transportuese. Rrjeti rrugor është i përshtatshëm për lëvizjen e mjeteve të rëndomta dhe makinerive të rënda, pa pasur nevojë për ndonjë ndërtim të ri rrugor.

6.32. Furnizimi me ujë

Furnizimi me ujë do të realizohet nga ujësjellësi duke siguruar nevojat për konsum dhe shërbime sanitare për stafin.

6.33. Energjia

Projekti do të sigurohet me energji elektrike nga rrjeti ekzistues, i cili është i përshtatshëm për mbulimin e nevojave për ndriçim, makineri dhe pajisje të tjera të nevojshme gjatë operimit.

6.34. Ujërat e zeza

Ujërat e zeza që krijohen janë vetëm nga ujërat për nevojat sanitare për këtë arsye do të shkarkohen në kanalizimin e fshatit.

6.35. Gjenerimi i mbeturinave

Gjatë funksionimit të projektit do të gjenerohen mbeturina nga procesi i pranimit, selektimit, riciklimit të plastikës dhe prodhimit të produkteve plastike. Mbeturinat kryesore lidhen me materialet e papërshtatshme që ndahen gjatë selektimit të plastikës, letrës, qelqit dhe aluminit. Nga procesi i selektimit mund të krijohen papastërti, materiale të përziera, ambalazhe të dëmtuara dhe mbetje që nuk janë të përshtatshme për riciklim. Këto mbeturina do të grumbullohen në kontejnerë të veçantë dhe do të dorëzohen te operatorët e licencuar për trajtim ose deponim përfundimtar.

Gjatë riciklimit të plastikës mund të krijohen mbetje nga grimcimi, filtrimi dhe pastrimi i materialit. Mbetjet plastike të pastra që krijohen gjatë prerjes dhe termoformimit do të rikthehen përsëri në procesin e riciklimit, duke zvogëluar sasinë e mbeturinave që largohen nga objekti.

Mbeturinat e letrës, qelqit dhe aluminit do të selektohen, magazinohen përkohësisht dhe do të përgatiten për dorëzim te subjektet që merren me riciklimin e tyre. Gjithashtu, do të krijohen edhe mbeturina komunale nga punëtorët, të cilat do të grumbullohen në enë të posaçme dhe do të largohen përmes shërbimit të autorizuar.

Në lokacion nuk parashihet djegie apo deponim i pakontrolluar i mbeturinave. Me ndarjen në burim, ruajtjen në hapësira të kontrolluara dhe dorëzimin të operatorët e licencuar, gjenerimi i mbeturinave pritet të jetë i menaxhueshëm.

6.36. Pasuritë e mbrojtura natyrore, kulturore dhe rrethina e tyre, veçoritë e peizazhit

Projekti nuk do të prek pasuritë natyrore, kulturore ose peizazhet e mbrojtura. Lokacioni është jashtë zonave të mbrojtura natyrore dhe kulturore dhe nuk ka ndikime të mundshme në këto pasuri.

6.37. Përshkrimi i ndikimeve të projektit në mjedis përmban gjithashtu informacionet që rezultojnë nga:

Në këtë vlerësim janë marrë parasysh të dhënat për objektin ekzistues, sipërfaqen e lokacionit, qasjen rrugore, furnizimin me ujë, kanalizimin, energjinë elektrike, afërsinë me objektet e banimit dhe praninë e rrjedhës ujore në afërsi të parcelave të projektit.

Gjithashtu janë marrë parasysh proceset teknologjike që zhvillohen në kuadër të projektit, përfshirë grumbullimin dhe selektimin e mbeturinave të plastikës, letrës, qelqit dhe aluminit, riciklimin e plastikës, prodhimin e granulatit, prodhimin e fletëve plastike dhe termoformimin. Informacionet e trajtuara përfshijnë ndikimet e mundshme në ajër, ujë, tokë, zhurmë, mbeturina, biodiversitet, peizazh, shëndetin e njeriut dhe sigurinë në punë. Po ashtu, janë shqyrtuar ndikimet nga qarkullimi i automjeteve, magazinimi i përkohshëm i materialeve, gjenerimi i mbeturinave të papërshtatshme dhe mundësia e ndikimeve aksidentale.

Në përgjithësi, ndikimet e projektit pritet të jenë lokale, të kufizuara dhe të menaxhueshme, me kusht që aktiviteti të zhvillohet brenda objektit ekzistues, mbeturinat të ndahen dhe ruhen në mënyrë të kontrolluar, pajisjet të mirëmbahen rregullisht dhe të zbatohen masat mbrojtëse të parapara në këtë raport.

6.38. Zbatimi i projektit, duke përfshirë punimet e largimit, sipas rastit

Në rast të përfundimit të funksionimit të projektit, do të bëhet çmontimi dhe largimi i pajisjeve teknologjike, pastrimi i objektit dhe largimi i të gjitha materialeve dhe mbeturinave të mbetura. Pajisjet që mund të ripërdoren do të largohen nga lokacioni, ndërsa mbetjet e papërdorshme do të menaxhohen përmes operatorëve të licencuar.

Pas punimeve të largimit, hapësira duhet të lihet e pastër dhe e sigurt, pa mbeturina të shpërndara dhe pa rrezik për ndotjen e tokës, ujërave, ajrit apo shëndetit të njeriut.

6.39. Ndikimet kumulative të projekteve të tjera ekzistuese

Ndikimet kumulative mund të lidhen me aktivitetet ekzistuese në zonë, qarkullimin rrugor, objektet afariste dhe aktivitetet e tjera të ngjashme përreth. Projekti do të zhvillohet në objekt ekzistues dhe ndikimet e tij pritet të jenë lokale. Me menaxhim të rregullt të mbeturinave, kontroll të zhurmës, ventilim dhe organizim të transportit, nuk priten ndikime kumulative të theksuara në mjedis.

6.40. Të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis

Shtrirja hapësinore e ndikimeve negative pritet të jetë e kufizuar kryesisht brenda lokacionit të projektit dhe në afërsi të drejtpërdrejtë të tij. Ndikimet e mundshme mund të lidhen me zhurmën, qarkullimin e automjeteve, manipulimin me mbeturina dhe emetimet e kufizuara nga përpunimi i plastikës. Duke qenë se aktiviteti zhvillohet brenda objektit ekzistues, ndikimet nuk pritet të shtrihen në distanca të mëdha.

6.41. Shkarkimi i ujërave të ndotura gjatë fazës së ndërtimit

Megjithatë projekti do të zhvillohet në objekt ekzistues dhe nuk parashihet ndërtim i ri, nuk pritet krijim i ujërave të ndotura nga faza e ndërtimit.

6.42. Emetimet e rrezatimit elektromagnetik gjatë ndërtimit

Për shkak të natyrës së projektit, nuk priten emetime të rrezatimit elektromagnetik gjatë fazës së ndërtimit.

6.43. Emetimet në ajër të gazrave serrë gjatë operimit

Gjatë operimit, emetimet e gazrave serrë pritet të jenë të kufizuara. Projekti nuk parasheh djegie të mbeturinave dhe nuk përdor lëndë djegëse në procesin teknologjik. Burimi kryesor indirekt i emetimeve lidhet me konsumin e energjisë elektrike dhe qarkullimin e automjeteve për transportin e mbeturinave dhe produkteve finale.

6.44. Ndikimet në ndryshimet klimatike

Ndikimi i projektit në ndryshimet klimatike pritet të jetë i ulët. Aktiviteti bazohet në grumbullimin, selektimin dhe riciklimin e mbeturinave të plastikës, letrës, qelqit dhe aluminit, që ndihmon në zvogëlimin e mbeturinave që përfundojnë në deponi dhe në ripërdorimin e materialeve. Projekti mund të jetë i ndjeshëm ndaj reshjeve të mëdha, temperaturave të larta dhe erërave të forta, prandaj materialet duhet të ruhen në hapësira të kontrolluara dhe oborri të mbahet i pastër.

7. PËRSHKRIMI I MASAVE PËR TË PARANDALUAR, REDUKTUAR OSE ELIMINUAR NDIKIMIN NË MJEDIS

7.1. Masat e parashikuara me legjislacion

Masat për parandalimin, reduktimin dhe eliminimin e ndikimeve në mjedis për projektin e kompanisë “Eco Recycling” SH.P.K. duhet të zbatohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e mjedisit, vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe menaxhimin e mbeturinave. Projekti i nënshtrohet kërkesave të Ligjit Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, si dhe kërkesave të legjislacionit për mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e mbeturinave. Operatori duhet të sigurojë që aktiviteti të zhvillohet vetëm pas pajisjes me pëlqimet, lejet dhe licencat e nevojshme mjedisore. Gjatë operimit, kompania duhet të respektojë kushtet e përcaktuara nga autoritetet kompetente, të mbajë evidencë për sasinë dhe llojin e mbeturinave të pranuar, të selektuara, të ricikluara dhe të dorëzuara te operatorët e licencuar.

Disa nga ligjet dhe udhëzimet që do të zbatohen për projektin janë:

Ligjet:

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025;
- Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr.08/L-181;
- Ligji për Mbeturina Nr. 04/L-060;
- Ligji nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-060 për mbeturina
- Ligji për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174;
- Ligji për Tokën Bujqësore Nr. 02/L- 26;
- Ligji për Mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102;
- Ligji për Ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147;
- Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja Nr. 08/L-025;
- Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr.03/L-233;
- Ligji për Mbrojtje nga Zjarri Nr. 08/L-261.

Udhëzimet Administrative:

- Udhëzim administrativ Nr.13/2013 për Katalogun Shtetëror të Mbeturinave;
- Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 07/2021 për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes;
- Udhëzimi Administrativ (MMPHI) për përmbajtjen, metodologjinë dhe përputhshmërinë e raportit me kërkesat ligjore, praktikat e zbatueshme dhe aspektet e tjera teknike të raportit

7.2. Masat që duhen marrë në rast aksidentesh dhe fatkeqësish të mëdha

Në Gjatë funksionimit të projektit të kompanisë “Eco Recycling” SH.P.K. duhet të parashihen masa për parandalimin dhe menaxhimin e aksidenteve të mundshme, sidomos për shkak të natyrës së aktivitetit që lidhet me grumbullimin, selektimin dhe riciklimin e mbeturinave të plastikës, letrës, qelqit dhe aluminit.

Rreziqet kryesore që mund të paraqiten janë zjarri, dëmtimi i pajisjeve teknologjike, lëndimi i punëtorëve gjatë punës me makineri, shpërndarja e mbeturinave në oborr, bllokimi i qarkullimit të brendshëm dhe derdhjet aksidentale gjatë pastrimit ose mirëmbajtjes së pajisjeve.

Për parandalimin e zjarrit, në objekt duhet të vendosen aparate për fikjen e zjarrit në pika të dukshme dhe lehtë të arritshme. Rrugët e evakuimit duhet të jenë të lira, pajisjet elektrike duhet të kontrollohen rregullisht dhe nuk duhet të lejohet pirja e duhanit apo përdorimi i flakës së hapur në hapësirat ku ruhen mbeturinat e plastikës, letrës dhe materialeve të tjera të ndezshme. Në rast zjarri ose aksidenti, punëtorët duhet të ndërpresin menjëherë punën, të njoftojnë personin përgjegjës dhe, sipas nevojës, Shërbimin e Zjarrfikësve, Emergjencën dhe Policinë. Evakuimi i punëtorëve duhet të bëhet përmes daljeve të sigurta, ndërsa ndërhyrja për fikjen e zjarrit duhet të bëhet vetëm nëse nuk rrezikohet jeta e personelit.

Për parandalimin e aksidenteve në punë, punëtorët duhet të trajnohen për përdorimin e pajisjeve, të përdorin pajisje mbrojtëse personale dhe të respektojnë udhëzimet teknike gjatë punës me pajisjet për selektim, grimcim, ekstrudim, granulim dhe termoformim. Pajisjet duhet të mirëmbahen rregullisht dhe të ndalen menjëherë në rast defekti.

Në rast të shpërndarjes së mbeturinave ose materialeve në oborr, ato duhet të mblidhen menjëherë dhe të vendosen në kontejnerë përkatës, me qëllim parandalimin e bartjes së tyre nga era ose reshjet drejt rrjedhës ujore në afërsi. Nuk lejohet hedhja e mbeturinave në tokë, në kanalizim apo në rrjedhën ujore.

Pas çdo aksidenti, kompania duhet të bëjë evidentimin e rastit, vlerësimin e shkakut, pastrimin e zonës së prekur dhe marrjen e masave korrigjuese për të parandaluar përsëritjen e ngjarjes. Me zbatimin e këtyre masave, rreziku nga aksidentet dhe fatkeqësitë e mëdha mund të zvogëlohet dhe të menaxhohet në mënyrë të sigurt.

7.3. Planet dhe zgjidhjet teknike për mbrojtjen e mjedisit

Për mbrojtjen e mjedisit gjatë funksionimit të projektit të kompanisë “Eco Recycling” SH.P.K. do të zbatohen masa teknike dhe organizative për secilin ndikim të mundshëm mjedisor.

Mbrojtja e ajrit - Proceset e riciklimit të plastikës, grimcimit, ekstrudimit, granulimit dhe termoformimit do të zhvillohen brenda objektit të mbyllur. Objekti duhet të ketë ventilim të

përshtatshëm, ndërsa pajisjet duhet të mirëmbahen rregullisht për të zvogëluar pluhurin, aromat dhe avujt eventuale nga ngrohja e plastikës. Në lokacion nuk lejohet djegia e mbeturinave.

Mbrojtja e ujërave - Ujërat sanitare do të shkarkohen në sistemin ekzistues të kanalizimit. Nuk lejohet shkarkimi i ujërave të ndotura në lumë, tokë apo kanale të hapura. Duke qenë se në afërsi të lokacionit gjendet një rrjedhë ujore mbi 10 m, mbeturinat duhet të ruhen në hapësira të kontrolluara dhe të parandalohet bartja e tyre nga reshjet atmosferike drejt rrjedhës ujore.

Mbrojtja e tokës - Mbeturinat e plastikës, letrës, qelqit dhe aluminit do të vendosen në hapësira të caktuara dhe në kontejnerë të veçantë. Nuk lejohet deponimi i mbeturinave në tokë të hapur. Oborri duhet të pastrohet rregullisht, ndërsa mbetjet që nuk janë të përshtatshme për riciklim duhet të dorëzohen te operatorët e licencuar.

Kontrolli i zhurmës - Zhurma nga pajisjet teknologjike do të kontrollohet përmes vendosjes së makinerive brenda objektit dhe mirëmbajtjes së tyre të rregullt. Pajisjet si shredderi, ekstruderi, granulatori, kompresori dhe pompa e vakumit duhet të jenë në gjendje të mirë teknike. Aktivitetet me zhurmë më të lartë duhet të zhvillohen në orare të përshtatshme, duke marrë parasysh afërsinë me objektet e banimit.

Menaxhimi i mbeturinave - Mbeturinat do të ndahen sipas llojit që në burim. Plastika e përshtatshme do të riciklohet, ndërsa letra, qelqi dhe alumini do të selektohen dhe magazinohen përkohësisht deri në dorëzim te operatorët përkatës. Mbetjet plastike të pastra nga prerja dhe termoformimi do të rikthehen në procesin e riciklimit. Mbeturinat e papërshtatshme do të grumbullohen veçmas dhe do të dorëzohen te operatorët e licencuar.

Mbrojtja nga ndikimet aksidentale - Në objekt duhet të vendosen pajisje për fikjen e zjarrit, sinjalizim dhe dalje të lira emergjente. Punëtorët duhet të trajnohen për përdorimin e pajisjeve, menaxhimin e mbeturinave dhe veprimet në rast aksidenti. Në rast të shpërndarjes së mbeturinave, derdhjeve apo defekteve teknike, puna duhet të ndërpritet deri në pastrimin dhe sanimin e gjendjes.

Mbrojtja e shëndetit të punëtorëve - Punëtorët duhet të përdorin pajisje mbrojtëse personale, si doreza, këpucë pune, maska sipas nevojës dhe mbrojtëse për dëgjim në zonat me zhurmë. Pajisjet teknologjike duhet të përdoren vetëm nga personeli i trajnuar dhe sipas udhëzimeve teknike.

Me zbatimin e këtyre masave, ndikimet e projektit në mjedis pritet të jenë të kontrolluara, lokale dhe të menaxhueshme.

7.4. Masat të tjera që mund të ndikojnë në parandalimin, zvogëlimin ose neutralizimin e efekteve të dëmshme në mjedis

Përveç masave teknike dhe ligjore, gjatë funksionimit të projektit të kompanisë “Eco Recycling” SH.P.K. duhet të zbatohen edhe masa shtesë organizative për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve në mjedis.

Këto masa janë të domosdoshme për të minimizuar ndikimet negative dhe për të siguruar një operim të qëndrueshëm dhe të kontrolluar. Disa nga këto masa përfshijnë:

- **Kufizimi i lëvizjes së makinerive:** Lëvizja e makinerive do të kufizohet vetëm në rrugët dhe hapësirat e përcaktuara brenda lokacionit, për të parandaluar përhapjen e pluhurit dhe dëmtimin e vegjetacionit përreth.
- **Shmangia e dëmtimit të vegjetacionit:** Do të ndërmerren masa për të shmangur dëmtimin e panevojshëm të vegjetacionit përreth zonës së projektit, duke respektuar habitate natyrore dhe ekosistemet që ndodhen në afërsi të lokacionit.
- **Respektimi i orarit të punës për kufizimin e zhurmës:** Orari i punës do të respektohet me rigorozitet për të kufizuar ndikimet nga zhurma, duke siguruar që aktivitetet të zhvillohen vetëm në orare të pranueshme për zonën dhe banorët përreth.
- **Përdorimi i pajisjeve mbrojtëse personale:** Punëtorët do të pajisen me pajisje mbrojtëse personale, sidomos gjatë operimeve pranë thërmuesve, sitave, shiritave transportues dhe zonave të ngarkimit, për të siguruar sigurinë e punonjësve dhe për të parandaluar dëmtimet e mundshme.
- **Vendosja e shenjave paralajmëruese dhe informuese:** Do të vendosen shenja paralajmëruese dhe informuese në zonën e punës për të udhëzuar punëtorët dhe për të parandaluar aksidentet gjatë operimit.
- **Kontrolli i rregullt i gjendjes teknike të pajisjeve dhe makinerive:** Makineritë dhe pajisjet do të kontrollohen rregullisht për të siguruar që ato funksionojnë në mënyrë efikase dhe pa rrezikuar ndotjen e mjedisit apo shëndetin e punëtorëve.
- **Monitorimi periodik i ndikimeve kryesore:** Do të bëhet monitorimi periodik i ndikimeve kryesore, sidomos pluhurit, zhurmës, mbeturinave dhe gjendjes së tokës, për të siguruar se ndikimet mbeten brenda kufijve të lejuar dhe janë të menaxhueshme.
- **Mbajtja e lokacionit të pastër dhe të organizuar:** Lokacioni i Qendrës do të mbahet i pastër dhe i organizuar gjatë gjithë periudhës së funksionimit për të parandaluar ndotjen e ambientit dhe për të siguruar kushte të sigurt për punë.

- **Grumbullimi i materialeve në zona të përcaktuara:** Do të ndalohet grumbullimi i pakontrolluar të materialeve jashtë hapësirave të përcaktuara, duke siguruar që mbeturinat të trajtohen dhe ruhet rendi dhe siguria në vendin e punës.
- **Pastrimi i rregullt i rrugëve të brendshme dhe hapësirave operative:** Rrugët e brendshme dhe hapësirat operative do të pastrehën rregullisht për të parandaluar krijimin e ndotjes nga grumbullimi i materialeve të papërdorura dhe për të mbajtur një ambient të sigurt për punëtorët dhe vizitorët.

Zbatimi i këtyre masave do të sigurojë që ndikimet e projektit në ajër, tokë, ujë, biodiversitet, peizazh dhe popullsi të jenë të kufizuara, të kontrolluara dhe të menaxhueshme gjatë gjithë periudhës së ndërtimit dhe funksionimit të qendrës.

8. PROGRAMI I MONITORIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

8.1. Programi i monitorimit të ndikimit në mjedis

Programi i monitorimit ka për qëllim kontrollimin e ndikimeve të mundshme gjatë funksionimit të projektit të kompanisë “Eco Recycling” SH.P.K., që përfshin grumbullimin dhe selektimin e mbeturinave të plastikës, letrës, qelqit dhe aluminit, si dhe riciklimin e plastikës dhe prodhimin e produkteve plastike.

Monitorimi do të fokusohet në cilësinë e ajrit, ujërave, tokës, zhurmës, menaxhimin e mbeturinave dhe sigurinë në punë. Për ajrin duhet të kontrollohet pluhuri, aromat eventuale dhe funksionimi i ventilimit. Për ujërat duhet të sigurohet që ujërat sanitare të shkarkohen në kanalizim dhe të mos ketë shkarkime në lumë apo në tokë.

Për tokën duhet të kontrollohet pastërtia e oborrit, vendosja e mbeturinave në kontejnerë dhe parandalimi i derdhjeve apo deponimeve të pakontrolluara. Për zhurmën duhet të monitorohet gjendja e makinerive dhe, në rast ankesash, të bëhen matje përkatëse.

Kompania duhet të mbajë evidencë për sasinë e mbeturinave të pranuar, të selektuara, të ricikluara dhe të dorëzuara te operatorët e licencuar. Monitorimi duhet të bëhet rregullisht nga personi përgjegjës i kompanisë dhe dokumentacioni të ruhet për kontroll nga autoritetet kompetente.

8.2. Prezantimi i gjendjes mjedisore para se projekti të vihet në punë ose fillimi i aktiviteteve në vendet ku ndikimi mjedisor pritet

Para fillimit të funksionimit të projektit, lokacioni në Zonën Kadastrale Milloshev, Komuna e Obiliqit, paraqitet si hapësirë me objekt ekzistues dhe infrastrukturë të siguruar, përfshirë qasjen rrugore, furnizimin me ujë, kanalizimin dhe energjinë elektrike.

Gjendja aktuale e lokacionit nuk paraqet ndërhyrje të re në tokë, pasi objekti është i ndërtuar dhe aktiviteti do të zhvillohet kryesisht brenda tij. Në afërsi të lokacionit gjenden objekte banimi, toka përreth dhe një rrjedhë ujore në distancë mbi 10 m, prandaj këta faktorë duhet të merren parasysh gjatë operimit.

Para vënies në punë, nuk priten ndikime të theksuara në ajër, ujë, tokë apo biodiversitet. Ndikimet e mundshme mund të paraqiten pas fillimit të aktivitetit, kryesisht nga qarkullimi i automjeteve, zhurma e makinerive, manipulimi me mbeturina dhe procesi i riciklimit të plastikës.

Për këtë arsye, gjendja fillestare mjedisore duhet të shërbejë si bazë krahasuese për monitorimin e mëvonshëm. Gjatë operimit duhet të përcillet pastërtia e lokacionit, cilësia e

menaxhimit të mbeturinave, shkarkimi i ujërave sanitare në kanalizim, zhurma, pluhuri dhe mbrojtja e rrjedhës ujore në afërsi.

8.3. Parametrat në bazë të cilave mund të përcaktohen efektet e dëmshme në mjedis

Efektet e mundshme të dëmshme në mjedis gjatë funksionimit të projektit mund të përcaktohen përmes monitorimit të disa parametrave kryesorë mjedisorë. Këta parametra lidhen me ajrin, ujin, tokën, zhurmën, mbeturinat dhe sigurinë në punë.

Për cilësinë e ajrit duhet të përcillen pluhuri, aromat eventuale, funksionimi i ventilimit dhe gjendja teknike e pajisjeve për grimcim, ekstrudim dhe termoformim. Nëse paraqiten shqetësime ose ankesa, mund të bëhen matje për pluhur dhe ndotës të tjerë në ajër.

Për ujërat duhet të përcillet shkarkimi i ujërave sanitare në sistemin e kanalizimit, mungesa e shkarkimeve në lumë apo në tokë, si dhe gjendja e rrjedhës ujore në afërsi të lokacionit. Duhet të kontrollohet që mbeturinat të mos barten nga reshjet atmosferike drejt rrjedhës ujore.

Për tokën duhet të monitorohet pastërtia e oborrit, ruajtja e mbeturinave në kontejnerë të përshtatshëm, mungesa e derdhjeve aksidentale dhe mos deponimi i mbeturinave në tokë të hapur.

Për zhurmën duhet të përcillet niveli i zhurmës nga makineritë dhe automjetet transportuese. Në rast të ankesave nga banorët përreth, duhet të realizohen matje të zhurmës dhe të krahasohen me normat e lejuara.

Për mbeturinat duhet të mbahet evidencë për sasinë dhe llojin e mbeturinave të pranuar, të selektuara, të ricikluara, të magazinuara dhe të dorëzuara te operatorët e licencuar. Po ashtu, duhet të kontrollohet mënyra e ndarjes dhe magazinimit të mbeturinave të plastikës, letrës, qelqit dhe aluminit.

Në aspektin e sigurisë në punë duhet të monitorohet përdorimi i pajisjeve mbrojtëse personale, gjendja e makinerive, pajisjet për fikjen e zjarrit, daljet emergjente dhe trajnimi i punëtorëve. Këta parametra ndihmojnë në identifikimin e hershëm të ndikimeve negative dhe në marrjen e masave korrigjuese.

8.4. Vendet, mënyra dhe shpeshtësia e matjes së parametrave të përcaktuar

Matjet do të realizohen brenda lokacionit të projektit dhe, sipas nevojës, në zonën përreth tij. Monitorimi do të kryhet në mënyrë periodike gjatë fazës së operimit, me shpeshtësi të përshtatur sipas natyrës së aktivitetit dhe kërkesave ligjore. Matjet do të realizohen përmes pajisjeve të certifikuara dhe, kur kërkohet, nga subjekte të autorizuar.

8.5. Përmbajtja dhe dinamika e dorëzimit të raporteve për matjet e kryera

Raportet e monitorimit do të përfshijnë rezultatet e matjeve, analizën dhe krahasimin e tyre me vlerat kufitare të lejuara, si dhe rekomandimet për masa korrigjuese nëse identifikohen devijime. Raportimi do të bëhet në baza periodike dhe do t’u dorëzohet autoriteteve kompetente në përputhje me legjislacionin në fuqi.

8.6. Detyrimin për informuar publikun për rezultatet e matjeve të kryera

Zbatuesi i projektit është i obliguar të sigurojë transparencë dhe të informojë publikun për rezultatet e monitorimit mjedisor, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Informimi do të realizohet përmes raporteve zyrtare dhe, sipas nevojës, përmes njoftimeve publike nga institucionet kompetente.

8.7. Programin ndërkufitar të monitorimit të ndikimit në mjedis

Duke marrë parasysh natyrën, shtrirjen dhe karakterin lokal të projektit, nuk parashikohen ndikime ndërkufitare në mjedis.

9. PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR

9.1. Mbrojtja efektive mjedisore gjatë gjithë fazave të projektit

Plani i Menaxhimit Mjedisor për projektin e kompanisë “Eco Recycling” SH.P.K. ka për qëllim sigurimin e mbrojtjes së mjedisit gjatë fazës përgatitore, gjatë funksionimit të rregullt dhe në rast të ndërprerjes së aktivitetit.

Gjatë fazës përgatitore, masat kryesore lidhen me organizimin e hapësirës ekzistuese, vendosjen e pajisjeve teknologjike, pastrimin e objektit dhe parandalimin e shpërndarjes së mbeturinave në lokacion. Çdo mbeturinë që krijohet gjatë montimit të pajisjeve duhet të ndahet sipas llojit dhe të dorëzohet te operatorët e licencuar.

Gjatë fazës së operimit, mbeturinat e plastikës, letrës, qelqit dhe aluminit duhet të pranohen, selektohen dhe ruhen në hapësira të kontrolluara. Plastika e përshtatshme do të riciklohet dhe do të përdoret për prodhimin e produkteve plastike, ndërsa letra, qelqi dhe alumini do të magazinohen përkohësisht dhe do të dorëzohen te subjektet e licencuara.

Për mbrojtjen e ajrit, proceset e grimcimit, ekstrudimit dhe termoformimit duhet të zhvillohen brenda objektit me ventilim të përshtatshëm. Për mbrojtjen e ujërave dhe tokës, nuk lejohet hedhja e mbeturinave në tokë, në lumë apo në kanale të hapura. Ujërat sanitare duhet të shkarkohen në sistemin ekzistues të kanalizimit.

Për kontrollin e zhurmës, makineritë duhet të mirëmbahen rregullisht dhe aktivitetet me zhurmë më të lartë duhet të zhvillohen brenda objektit. Duke marrë parasysh afërsinë me objektet e banimit, kompania duhet të kujdeset që transporti, ngarkimi dhe shkarkimi të organizohen në mënyrë të kontrolluar.

Gjatë gjithë fazave të projektit, kompania duhet të mbajë evidencë për mbeturinat e pranuar, të selektuara, të ricikluara dhe të dorëzuara. Po ashtu, punëtorët duhet të trajnohen për përdorimin e pajisjeve, ndarjen e mbeturinave, masat e sigurisë në punë dhe veprimet në rast aksidenti.

Në rast të ndërprerjes së aktivitetit, duhet të bëhet pastrimi i objektit, largimi i pajisjeve dhe dorëzimi i të gjitha mbeturinave te operatorët e licencuar. Lokacioni duhet të lihet i pastër, i sigurt dhe pa rrezik për ndotjen e tokës, ujërave, ajrit apo shëndetit të njeriut.

9.2. Pajtueshmëria me pëlqim mjedisor

Zbatimi i projektit do të realizohet në përputhje të plotë me kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në pëlqimin mjedisor, dhe me të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi. Kompania do të ketë përgjegjësinë për të zbatuar të gjitha masat mbrojtëse mjedisore të parashikuara në këtë raport,

për të monitoruar ndikimet mjedisore dhe për të menaxhuar mbeturinat në përputhje me legjislacionin. Përgjegjësitë përfshijnë:

- Monitorimin e rregullt të ndikimeve mjedisore;
- Menaxhimin e mbeturinave metalike dhe të tjera sipas Katalogut Shtetëror;
- Raportimin periodik ndaj institucioneve kompetente;
- Bashkëpunimi me autoritetet mbikëqyrëse.

Nëse ka ndryshime të mundshme në aktivitet, kapacitet ose teknologji, ato do të trajtohen sipas procedurave ligjore përkatëse.

9.3. Inkurajimi I zhvillimit të sistemit të menaxhimit mjedisor në përputhje me standardin ISO 14000

“Eco Recycling” SH.P.K. do të zhvillojë dhe implementojë një sistem të menaxhimit mjedisor në

përputhje me standardin ISO 14000. Ky sistem ka për qëllim:

- Identifikimin dhe kontrollin e ndikimeve mjedisore;
- Përmirësimin e efikasitetit operativ në menaxhimin e mbeturinave;
- Rritjen e ndërgjegjësisë dhe përgjegjësisë mjedisore të stafit;
- Përbushjen e vazhdueshme të kërkesave ligjore dhe institucionale.

Ky sistem do të zhvillohet në mënyrë graduale dhe të kontrolluar, duke u përshtatur me shkallën dhe natyrën e aktiviteteve të Qendrës së Grumbullimit të plastikës, letrës, qelqit dhe aluminit, si dhe me riciklimin e plastikës dhe prodhimin e produkteve të plastikës.

10. INFORMACIONE SHITESË DHE KARAKTERISTIKAT E PROJEKTIT

10.1. Informacionet dhe karakteristikat shitesë të projektit për përcaktimin e qëllimit dhe përmbajtjes së raportit të VNM -së,

Ky raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) është përgatitur për të vlerësuar ndikimet e mundshme mjedisore të projektit të propozuar nga kompania “Eco Recycling” SH.P.K. që lidhen me grumbullimin, përpunimin dhe riciklimin e mbeturinave të letrës, plastikës, qelqit, metaleve dhe mbeturinave të tjera jo të rrezikshme, në përputhje me ligjin dhe rregullat e Kosovës për menaxhimin e mbeturinave.

Qëllimi i këtij raporti është të sigurojë që aktivitetet e projektit janë të miratuara dhe të realizohen në përputhje me kërkesat e mjedisit dhe ligjit, duke minimizuar ndikimet negative dhe duke promovuar praktikat e qëndrueshme. Ky raport gjithashtu përfshin një vlerësim të detajuar të ndikimeve mjedisore potenciale dhe masat që do të merren për t'i kontrolluar ato, si dhe identifikimin e mundësive për përmirësimin e efikasitetit operativ dhe ruajtjen e mjedisit gjatë gjithë periudhës së projektit.

Përmbajtja e raportit të VNM-së përfshin:

- Përshkrimi i projektit dhe aktiviteteve të planifikuara,
- Identifikimi i ndikimeve mjedisore dhe masat për zvogëlimin e tyre,
- Procedurat e monitorimit të ndikimeve gjatë fazës së ndërtimit dhe operimit,
- Përputhshmëria me ligjin dhe rregulloret mjedisore në fuqi,
- Vlerësimi i mundësive për zhvillimin e sistemit të menaxhimit mjedisor sipas standardeve ndërkombëtare (ISO 14000).

Ky raport ka si qëllim të garantojë se të gjitha fazat e projektit, nga ndërtimi deri në operim, do të zhvillohen në mënyrë që të sigurohet mbrojtja e mjedisit dhe përputhshmëria me kërkesat ligjore dhe rregullatore për mbeturinat dhe menaxhimin e tyre.

11. BURIMET E TË DHËNAVE

11.1. Lista e referimit të burimeve e të dhënave të përdorura për përshkrimet dhe vlerësimet e dhëna në raportin e VNM-së

Lista e bibliografisë (referencave) së burimeve të përdorura për përshkrimet dhe vlerësimet e përfshira në raport.

- *Te dhënat nga investitori,*
- [42°43'32.3"N 21°04'16.7"E - Google Maps](https://www.google.com/maps/@42.7216667,21.0694444,15z)
- <https://www.scribd.com/document/856412247/pzhk>
- [Kosovo Geoportal](#)
- [pzhk.pdf](#)
- *Ligji nr. 08/l-181 për vlerësimin e ndikimit në mjedis (rks-gov.net)*
- *Udhëzim administrativ nr. 13/2013 për katalogun shtetëror të mbeturinave*
- *Udhëzim administrativ (mmphi) nr.04 2025 për pëmbajtjen, metodologjinë dhe përputhshmërinë e raportit me kërkesat ligjore , praktikat e zbatueshme dhe aspektet e tjera teknike të*

12. SHTOJCA

1. Raporti i VNM-së i nënshkruar nga aplikuesi dhe personi fizik apo juridik i pajisur me licencë nga Ministria për hartimin e raporteve të VNM-së, me një (1) kopje në formë të shkruar dhe një (1) kopje në formë elektronike.
2. Dëshmia e pagesës për aplikim për pëlqim mjedisor.
3. Vlera investive e projektit në formë tabelare.
4. Certifikata e regjistrimit të biznesit.
5. Certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme.
6. Kopja e planit me koordinata në sistemin Kosova Ref.
7. Plani i rilevimit të terrenit nga gjeodeti i licencuar, si dhe kopja e licencës së gjeodetit.
8. Pëlqimi i Komunës për ushtrimin e veprimtarisë ose njoftim/informimi sipas Planit Zhvillimor Komunal, Hartës Zonale dhe kushteve ndërtimore.
9. Licenca valide e personit fizik ose juridik, e lëshuar nga Ministria.

13. PËRMBLEDHJA JO-TEKNIKE E INFORMACIONIT

13.1. Hyrje

Ky raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është përgatitur për projektin e kompanisë “Eco Recycling” SH.P.K., për qendrën e grumbullimit dhe selektimit të mbeturinave të plastikës, letrës, qelqit dhe aluminit, si dhe për riciklimin e plastikës dhe prodhimin e produkteve plastike. Projekti planifikohet të zhvillohet në Zonën Kadastrale Milloshev, Komuna e Obiliqit.

Qëllimi i projektit është grumbullimi, selektimi dhe menaxhimi i mbeturinave të plastikës, letrës, qelqit dhe aluminit, si dhe riciklimi i plastikës për prodhimin e granulatit, fletëve plastike dhe produkteve plastike përmes procesit të termoformimit.

Projekti ka rëndësi mjedisore, pasi kontribuon në zvogëlimin e sasisë së mbeturinave që përfundojnë në deponi, në ripërdorimin e materialeve dhe në zhvillimin e ekonomisë qarkore. Aktiviteti nuk parasheh djegie të mbeturinave dhe nuk përfshin procese të rënda kimike.

Hartimi i këtij raporti bazohet në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe në kërkesat ligjore në fuqi për mbrojtjen e mjedisit. Në raport janë trajtuar ndikimet e mundshme në ajër, ujë, tokë, zhurmë, mbeturina, shëndetin e njeriut dhe sigurinë në punë, si dhe masat për parandalimin dhe zvogëlimin e këtyre ndikimeve.

13.2. Përshkrimi i projektit

Projekti i kompanisë “Eco Recycling” SH.P.K. ka të bëjë me funksionimin e qendrës për grumbullimin dhe selektimin e mbeturinave të plastikës, letrës, qelqit dhe aluminit, si dhe me riciklimin e plastikës dhe prodhimin e produkteve plastike.

Aktiviteti do të zhvillohet në objekt ekzistues në Zonën Kadastrale Milloshev, Komuna e Obiliqit, në ngastra kadastrale P-72614051-00116-0. Sipërfaqja e përgjithshme e lokacionit është 8169 m², ndërsa objekti ekzistues ka sipërfaqe prej 2390.95 m². Në fazën e parë do të bëhet pranimi dhe selektimi i mbeturinave të plastikës, letrës, qelqit dhe aluminit. Letra, qelqi dhe alumini do të ndahen sipas llojit, do të magazinohen përkohësisht dhe do të përgatiten për dorëzim te operatorët e licencuar ose subjektet që merren me riciklimin e tyre.

Pjesa kryesore e procesit teknologjik lidhet me riciklimin e plastikës. Plastika e përshtatshme do të selektohet, grimcohet, përpunohet përmes ekstrudimit dhe filtrimit, pastaj do të shndërrohet në granulat plastik. Ky granulat do të përdoret si lëndë e parë për prodhimin e fletëve plastike dhe produkteve plastike përmes termoformimit.

Procesi do të zhvillohet brenda objektit të mbyllur dhe nuk parasheh djegie të mbeturinave apo përdorim të proceseve të rënda kimike. Mbetjet plastike të pastra që krijohen gjatë

prodhimit do të rikthehen përsëri në proces, ndërsa mbeturinat e papërshtatshme do të grumbullohen veçmas dhe do të dorëzohen te operatorët e licencuar.

Lokacioni ka qasje rrugore, furnizim me ujë, kanalizim dhe energji elektrike. Qëllimi i projektit është zvogëlimi i sasisë së mbeturinave që përfundojnë në deponi, rritja e riciklimit dhe prodhimi i produkteve të reja plastike nga materiali i ricikluar.

13.3. Ndikimet kryesore mjedisore dhe masat mbrojtëse

Ndikimi në ajër mund të paraqitet nga pluhuri gjatë manipulimit dhe grimcimit të plastikës, nga qarkullimi i automjeteve dhe nga aromat e lehta gjatë ekstrudimit dhe termoformimit. Ky ndikim pritet të jetë i kufizuar, pasi procesi zhvillohet brenda objektit të mbyllur dhe nuk parashihet djegie e mbeturinave.

Masat mbrojtëse përfshijnë ventilimin e objektit, mirëmbajtjen e rregullt të pajisjeve, pastrimin e hapësirave të punës dhe ndalimin e plotë të djegies së mbeturinave në lokacion.

Ndikimi në ujë - Në afërsi të lokacionit gjendet një rrjedhë ujore në distancë mbi 10 m, prandaj duhet të parandalohet çdo bartje e mbeturinave ose ujërave të ndotura drejt saj. Projekti nuk parasheh shkarkim të drejtpërdrejtë të ujërave të ndotura në lumë apo në tokë.

Masat mbrojtëse përfshijnë shkarkimin e ujërave sanitare në kanalizim, ruajtjen e mbeturinave në hapësira të kontrolluara, vendosjen e kontejnerëve në sipërfaqe të përshtatshme dhe pastrimin e rregullt të oborrit.

Ndikimi në tokë - Ndikimi në tokë mund të ndodhë në rast të shpërndarjes së mbeturinave në oborr, deponimit të pakontrolluar ose derdhjeve aksidentale gjatë pastrimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve. Duke qenë se projekti zhvillohet në objekt ekzistues, nuk pritet humbje e tokës apo ndërhyrje e madhe në sipërfaqe.

Masat mbrojtëse përfshijnë ndarjen e mbeturinave sipas llojit, ruajtjen e tyre në kontejnerë të veçantë, ndalimin e deponimit në tokë të hapur dhe dorëzimin e mbeturinave të papërshtatshme te operatorët e licencuar.

Ndikimi nga zhurma - Zhurma mund të krijohet nga pajisjet teknologjike, si pajisja për grimcim, ekstruderi, granulatori, makina e termoformimit, kompresori dhe pompa e vakumit. Duke marrë parasysh afërsinë me objekte banimi, ky ndikim duhet të kontrollohet gjatë operimit.

Masat mbrojtëse përfshijnë vendosjen e pajisjeve brenda objektit, mirëmbajtjen e tyre të rregullt, organizimin e punës në orare të përshtatshme dhe përdorimin e pajisjeve mbrojtëse për punëtorët në zonat me zhurmë.

Ndikimi nga mbeturinat - Gjatë procesit do të krijohen mbetje nga selektimi, papastërti, materiale të kontaminuara dhe mbetje plastike nga prerja dhe termoformimi. Mbetjet plastike të pastra mund të rikthehen në procesin e riciklimit.

Masat mbrojtëse përfshijnë ndarjen e mbeturinave në burim, magazinimin e përkohshëm sipas llojit, riciklimin e plastikës së përshtatshme, ruajtjen e letrës, qelqit dhe aluminit në hapësira të veçanta dhe dorëzimin e mbetjeve të papërshtatshme te operatorët e licencuar.

Ndikimi në shëndetin e njeriut - Ndikimi në shëndetin e njeriut mund të lidhet me zhurmën, pluhurin, punën me makineri, temperaturat gjatë përpunimit të plastikës dhe rrezikun nga aksidentet në punë. Për banorët përreth, ndikimet pritet të jenë të kufizuara nëse aktiviteti zhvillohet brenda objektit dhe menaxhohet siç duhet.

Masat mbrojtëse përfshijnë trajnimin e punëtorëve, përdorimin e pajisjeve mbrojtëse personale, vendosjen e sinjalizimit, mirëmbajtjen e pajisjeve, sigurimin e daljeve emergjente dhe pajisjeve për fikjen e zjarrit.

Ndikimi në biodiversitet dhe peizazh -Ndikimi në biodiversitet dhe peizazh pritet të jetë i ulët, pasi projekti zhvillohet në objekt ekzistues dhe nuk parasheh ndërhyrje në habitate natyrore, prerje të vegjetacionit apo ndryshim të relievit.

Masat mbrojtëse përfshijnë mbajtjen e pastër të hapësirës, parandalimin e shpërndarjes së mbeturinave nga era ose reshjet dhe ruajtjen e materialeve në hapësira të kontrolluara.

Në përgjithësi, ndikimet kryesore mjedisore të projektit vlerësohen si lokale, të kufizuara dhe të menaxhueshme, me kusht që të zbatohen masat e parapara për mbrojtjen e ajrit, ujit, tokës, kontrollin e zhurmës dhe menaxhimin e mbeturinave.

13.4. Përfitimet socio-ekonomike

Një nga përfitimet kryesore është krijimi i vendeve të reja të punës për punëtorë lokalë, si në procesin e pranimin dhe selektimit të mbeturinave, ashtu edhe në operimin e linjave për riciklimin e plastikës dhe prodhimin e produkteve plastike. Kjo ndikon pozitivisht në punësim dhe në zhvillimin ekonomik lokal.

Projekti kontribuon edhe në zvogëlimin e sasisë së mbeturinave që përfundojnë në deponi, duke rritur nivelin e riciklimit dhe ripërdorimit të materialeve. Përmes këtij aktiviteti, mbeturinat plastike kthehen në granulat, fletë plastike dhe produkte të reja, duke krijuar vlerë ekonomike nga materiale që përndryshe do të trajtoheshin si mbeturina.

Po ashtu, projekti mund të krijojë bashkëpunim me operatorë të tjerë për grumbullimin, transportin dhe riciklimin e mbeturinave, si dhe me biznese që përdorin produkte plastike ose

materiale të ricikluara. Kjo ndihmon në zhvillimin e ekonomisë qarkore dhe në forcimin e sektorit të riciklimit.

Nga aspekti shoqëror, projekti ndikon në rritjen e vetëdijes për ndarjen dhe menaxhimin më të mirë të mbeturinave. Me funksionimin e rregullt dhe zbatimin e masave mjedisore, projekti mund të kontribuojë në një mjedis më të pastër dhe në shfrytëzim më të qëndrueshëm të resurseve.

13.5. Përfundim

Në bazë të vlerësimit të bërë, projekti i kompanisë “Eco Recycling” SH.P.K. për qendrën e grumbullimit dhe selektimit të mbeturinave të plastikës, letrës, qelqit dhe aluminit, si dhe për riciklimin e plastikës dhe prodhimin e produkteve plastike, vlerësohet si projekt me ndikime lokale dhe të menaxhueshme në mjedis.

Projekti do të zhvillohet në objekt ekzistues në Zonën Kadastrale Milloshev, Komuna e Obiliqit, në ngastra kadastrale P-72614051-00116-0. Lokacioni ka qasje rrugore, furnizim me ujë, kanalizim dhe energji elektrike, prandaj nuk kërkohet ndërtim i infrastrukturës së re.

Distanca më e afërt nga kufiri i parcelës së projektit deri te objekti më i afërt i banimit është rreth 20 m. Në afërsi të lokacionit gjenden edhe objekte afariste dhe hapësira pune, të cilat duhet të merren parasysh gjatë organizimit të transportit, ngarkim-shkarkimit dhe funksionimit të pajisjeve. Po ashtu, në afërsi të lokacionit gjendet një rrjedhë ujore në distancë mbi 10 m, prandaj menaxhimi i mbeturinave dhe pastrimi i hapësirës duhet të bëhen në mënyrë të kontrolluar.

Ndikimet kryesore të projektit lidhen me zhurmën nga makineritë, pluhurin e lehtë gjatë manipulimit dhe grimcimit të plastikës, aromat eventuale gjatë ekstrudimit dhe termoformimit, qarkullimin e automjeteve dhe krijimin e mbetjeve nga selektimi. Këto ndikime nuk pritet të jenë të mëdha, pasi aktiviteti zhvillohet brenda objektit të mbyllur dhe nuk parasheh djegie të mbeturinave apo procese të rënda kimike.

Me zbatimin e masave mbrojtëse, si ventilimi i objektit, mirëmbajtja e pajisjeve, ruajtja e mbeturinave në hapësira të kontrolluara, dorëzimi i mbetjeve te operatorët e licencuar, kontrolli i zhurmës dhe mbrojtja e rrjedhës ujore në afërsi, projekti mund të zhvillohet pa ndikime të rëndësishme negative në mjedis.

Në përgjithësi, projekti ka edhe ndikim pozitiv, pasi kontribuon në zvogëlimin e sasisë së mbeturinave që përfundojnë në deponi, rritjen e riciklimit, ripërdorimin e materialeve dhe zhvillimin e ekonomisë qarkore.